



Komuna Suharekë
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

30-06-2025

REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E SUHAREKË OPSTINE SUVA REKA - OPSTINA SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
NIS PRIL - ZIM-PRIL - ENO-RECEIVED			
No. of Org. Acct. No.	Pril Pril	Eno Eno	Value Value
01	052	36888	£

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN JANAR- QERSHOR 2025

E-mail bali.muharremaj@rks-gov.net

Website: <https://suhareke.rks-gov.net/>

Përmbajtja

1. DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI
2. DREJTORIA PËR ARSIM
3. DREJTORIA PËR URBANIZEM PLANIFIKIM DHE MJEDIS
4. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
5. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË
6. DREJTORIA PËR EKONOMI BUXHET DHE FINANCA
7. DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORT DHE MËRGATË
8. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË
9. DREJTORIA PËR SHËRBIME PRONSORE-JURIDIKE DHE KADASTER
- 10.DREJTORIA PËR INSPEKSION

DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari gjatë muajve Janar, Shkurt dhe Mars ka realizuar aktivitete dhe punë të shumta të ndara sipas sektoreve të Drejtorisë.

Kemi inicuar disa nga procedurat tenderuese për projektet kapitale që janë të planifikuara në bugjet të realizohen për vitin 2025.

Deri në këtë periudhë kemi inicuar këto projekte:

1. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për Bujqësi dhe Pylltari.
2. Ndërtimi i Serave për fermerë.
3. Trajtimi i qenëve endacak.
4. Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit- faza e dytë.
5. Ndërtimi i sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore në Studençan.
6. Ndërtimi i kanalit të lagjja Bylykbashi në Samadraxhë.
7. Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit, faza e dytë.

Për të gjitha këto projekte janë punuar paramasat dhe parallogaritë dhe janë dorzuar në Zyren e Prokurimit dhe janë në fazën e inicimit dhe shumica prej tyre nisin realizimin në fillim të muajit Korrik.

Poashtu edhe shumë projekte të tjera me bashkëfinancim kemi përgaditu procedurat, duke pasur parasysh se projektet me bashkëfinancim janë tek Drejtoria e Bujqësisë.

NDËRTIMI I SISTEMIT TË UJITJES SË SIPËRFAQEVE BUJQËSORE

Së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural këtë vit po realizojmë projektin për Ndërtimin e sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore në Komunën e Suharekës, në vlerë prej rreth 300,000.00 €.

Ne si Dejtori kemi dorëzuar projektin kryesor në Ministri dhe presim gjatë muajit Prill të nënshkruajmë marrëveshjen e bashkpunimit me Ministrinë dhe të fillojmë me procedurën e prokurimit. Projekti është duke u realizuar në tre lokacione në fshatrat Vraniq, Studençan dhe Mushtisht.

Sipas projektit do realizohen 6000 metra.



Ndertimi i Serave për fermerë:

Si Drejtori kemi përcjell për prokurim projektin “Ndërtimin e Serave dhe kemi përfunduar thirrjen për aplikim ku kanë aplikuar rreth mbi 200 fermerë.

Fermerët do të subvencionohen me 3 lloje të Serave me sipërfaqe prej :

100 m² , 200m² dhe 500m².

Ky projekt pritet të filloj në mujin Korrik

TRAJTIMI I QENEVE ENDACAK

Trajtimi i qeneve endacak është në kuadër të përgjegjësisë së Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

Aktualisht jemi në fazën e realizimit të projektit, ku kompania po bënë realizimin e kontratës sipas nevojave dhe kërkesave të qytetareve.

Marrveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me organizaten “QATAR CHARITY”

Kemi nënshkruar marrveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me organizaten “QATAR CHARITY” për furnizim me Sera të sipërfaqeve prej 96 m², kur pritet të përfitojnë rreth 50 fermerë kryesisht me kushte të vështira ekonomike.

Marrveshja parasheh që 80% të vlerës e mbulon Qatar, kurse 20% të vlerës e mbulon Komuna e Suharekës.

Ka përfunduar thirrja për aplikim dhe si përzgjedhja e përfituesve dhe pritet të filloj ndërtimi i serave për fermerët përfitues.

Poashtu kemi në realizim edhe me organizaten Katar 10 përfitues me Koshere të bleteve edhe 6 inkubator për shpeztari.



SUBVENCIONIMI I QUMSHTIT

Në kuadër të projektetve të realizuar me Subvencione si Drejtori për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, jemi duke e bërë subvencionimin e qumshtit me 0.03 cent për fermerët blegoral.

Këtë 6 mujor kemi hapur thirrjen për aplikim për subvencionim të qumshtit për 6 mujorin e II-të të vitit 2024, ku kanë aplikuar gjithsej 72.

Komisioni i Drejtorisë është në ka bërë shqyrtimin e aplikacioneve dhe ka dërguar për pagesë.

Subvencionim i qumshtit do të vazhdoj ku pas muajit qershor hapim thirrjen për 6 mujorin e parë të vitit 2025.

SUBVENCIONET – Pagesat Direkte

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari është në fazen e përgaditjeve për Pagesa Direkte – Subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Si Drejtori për Bujqësi kemi relaizuar me sukses fazen e aplikimit për pagesa direkte, kemi rritur stafin, kemi zgjatur orarin e punës, poashtu kemi punuar edhe të shtuneve në mënyrë që të mos mbetet asnjë fermerë pa aplikuar.

Marrveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me organizaten “Mëshqerra”

Krahasa subvencionimit të qumshtit që realizojmë që 3 vite, Drejtoria e Bujqësisë synon të arrin marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me organizaten për Zhvillim Rajonal “Mëshqerra”, për realizimin e projektit për furnizim me lop qumështore të races më të mirë Hollshtajn Frizis.



Marrveshje bashkpunimi me Islamic Relief Kosova

Jemi në fazën e realizimit të marrveshës së bashkfinancimi me Islamic Relief Kosova për subvecionimin e fermereve me mekanizëm bujqësor.

Vlera financiare e marrveshjes 296,956.52€.

Llojet e mekanizmit bujqësor janë:

1. Freza 1.60 m
2. Freza 1.80m
3. Mbjellse gruri
4. Mbjellse Misri
5. Motokultivatr me frezë dhe kos
6. Motokultivator 4.4 kw
7. Labina 7.5 kw me frezë
8. Automizer

Kemi përfunduar thirrjen për aplikim, ku kanë aplikuar mbi 900 fermerë.

Komisioni ka bërë përzgjedhjen e fermereve përfitues që kanë plotësuar kriteret, ku kanë përfitur 290 fermerë.

Marrëveshje bashkëpunimi me IADK

Në kuader të bashkëpunimit 3 vjeçar që ka Komuna e Suharekës me organizatën Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës për projektin “Përmirsimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës, projekt tre vjeçar 2023-2025, kemi hapur thirrjen publike për aplikim për fermeret e vegjel për mbështetje të fermereve të vegjel në sektorin e blgtorisë dhe horticultures (pemë dhe perime) me ide dhe aktivitete të përshatshme për digjitalizim dhe ndryshime klimatike.

Së bashku me IADK kemi hapur thirrje për aplikim për fermerët për disa lloje të granteve:

Mbështetja finaciare

- Granti i kërkuar nga IADK, duhet të jetë sipas ndarjeve të mëposhtme:
 - a. Vlera e mbështetur nga projekti është deri: 600.00 Euro
 - b. Çdo vlerë tjetër mbi 600.00 Euro, do të përfshijë bashkëfinancimin e fermerit.

Kostot e pranueshme për financim

Aktivitetet/kostot të cilët mund të financohen në kuadër të projektit:

I. GRANTE PËR DIGJITALIZIM TË AKTIVITETEVE NË PERIME – SERRË

1. **Furnizimi dhe instalimi i sistemit të ujitjes së kontrolluar nga telefoni i mençur për serra me sipërfaqe minimale 500m².**
2. **Furnizimi dhe montimi i motorëve për hapje të dy dritareve anësore të serres - manual përmes ndërprerësit, serra duhet të ketë sipërfaqe minimale 500m².**
 - kostoja totale e investimit të llogaritur është 880.00 €, përmes grantit IADK do të mbulojë shumën 600 €, ndërsa përfituesi/fermeri do të bashkëfinancojë në vlerën 280.00 €

II. GRANTE PËR ADRESIMIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË PERIME – SERRË

1. **Furnizimi me rrjeta për hijezim të serrave me sipërfaqe 500m² e më tepër.**
 - kostoja totale e investimit të llogaritur për 2000 m² serrë është 600.00 €, por fermerët mund të aplikojnë për mbulim të serrave me sipërfaqe jo më të vogla se 500m².
2. **Furnizimi me rezervuar plastik 3000L dhe elemente përcjellëse për grumbullim të ujit të shiut nga serra, për serrat jo më të vogla se 500m²**
 - Kostoja totale e investimit të llogaritur është 600.00 €, përmes grantit IADK do të mbulojë këtë shumë, gjdo vlerë mbi këtë shumë për kapacitet shtesë të rezervuarit apo elementeve shtesë do të bashkëfinancohet nga përfituesi/fermeri.

III. GRANTE PËR ADRESIMIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË PEMËTARI – MJEDËR DHE DREDHËZ

1. **Furnizimi dhe montimi i serrës me konstruksion të lehtë nga metali i zingtuar për mbulim dredhëzave me sipërfaqe 150m².**
 - kostoja totale e investimit të llogaritur për këtë sipërfaqe është 810.00 €, përmes grantit IADK do të mbulojë shumën 600 €, ndërsa përfituesi/fermeri do të bashkëfinancojë në vlerën 210.00 €.
2. **Furnizimi dhe montimi i kornizave të lehta nga metali i zingtuar për vendosjen e rrjetave për hijezimin e mjedrave.**
 - kostoja totale e investimit të llogaritur është 600.00 € për fermerë dhe do të mbulohet përmes grantit të IADK-së. Përtej kësaj vlere shtesë do të bashkëfinancohet nga përfituesi/fermeri.

DREJTORIA PËR ARSIM

Planifikimi i objektivave të DKA-së

Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës tremujore kishte për qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor të punës për vitin 2025 të cilat janë të mbështetura në objektivat kombëtare dhe strategjike të MASHTI si dhe objektivat komunale në PZHK të DKA-së të miratuar nga Asambleja Komunale të cilat janë shndërruara në detyra konkrete siç janë:

- Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në të gjitha shkollat
- Ngritjen e suksesit të nxënësve dhe rritjen e nivelit të vijueshmërisë së nxënësve në procesin edukativo-arsimor.
- Realizimin e plan-programeve mësimore sipas fushave të KKK
- Plotësimin e kuadrit arsimor përmes konkurseve publike
- Vlerësimi i brendshëm i performancës së mësimdhënësve
- Rilicencimi i mësimdhënësve (ripertritja e licensës së karrierës)
- Vlerësimin e performancës së drejtorëve /zv.drejtorëve të shkollave .
- Menaxhimi i sigurisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe në të gjitha institucionet edukativo- arsimore.
- Përgatitjet për organizimin e vlerësimeve të njohurive të nxënësve kombëtare : Testi i arritshmërisë – kl.9 dhe testi i maturës- kl.12 dhe vlerësimi ndërkombëtar PISA -2025 ,garave dhe aktiviteteve për nxënësit e të gjitha niveleve të shkollimit me qëllim të motivimit të nxënësve dhe mësimdhënësve për ngritje të cilësisë në arsim.
- Rregullimin, pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambientit të brendshme dhe të jashtëm të shkollave ruajtjen e shëndetit të nxënësve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë

Organizimi dhe menaxhimi i punës në 29 SHFMU me paralele të ndara , 3 SHML si dhe institucioni parashkollor –çerdhja e fëmijëve “Flutura” me 7 (shtatë) paralele të ndara në Duhël, Mushtisht, Sopijë, Gjinoc, Studenqan, Samadraxhë dhe Bukosh krijon kushte optimale për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor. Në këtë vit shkollor mësimi në një ndërrim organizohet në : 22 SHFMU si shkolla amë me paralele të ndara fizike dhe SHML “A. Ramaj” në Shirokë.

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit në komunën tonë

Planifikimi i numrit të nxënësve dhe paraleleve për vitin shkollor 2024/2025 është bërë në bashkëpunim me shkollat fillore dhe në mbështetje të UA nr. 03/2022 për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore dhe UA nr. 09 /2023-Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të MASHT .Në bazë të këtij planifikimi janë regjistruar nxënësit në klasat e para dhe fëmijët në çerdhen “Flutura” Suharekë. Ndërsa planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme të larta është realizuar në bashkëpunim me MASHTI dhe SHML sipas kërkesave të tregut të punës në komunën tonë.

- ❖ Për vitin shkollor 2024/2025 numri i nxënësve është 8461 (duke përfshirë edhe çerdhen “Flutura” në Suharekë). Në krahasim me vitin shkollor 2023/24 numri i nxënësve është zvogëluar për 413 nxënës. Vlen të theksohet se zvogëlim të numrit të nxënësve ka në të gjitha shkollat rurale kurse rritje në ato urbane.

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Suharekës


Nr.	Shkollat	Nxënës të regjistruar		
		F	M	Gjithsej
1	Qerdhe/Parafillor	98	119	217
2	Shkollat fillore dhe te mesme te ulta	3002	3346	6348
3	Gjimnazi“ JETA E RE”	335	225	560
4	IAAP “ Skënder Luarasi”	163	507	670
5	IAAP “ Abdyl Ramaj”	431	235	666
	Totali	4029	4432	8461

Suksesi i nxenesve në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025

Sipas raporteve të shkollave dhe të dhënave të paraqitura në sistemin SMIA të MASHTI suksesi dhe vijueshmëria e nxënësve është i kënaqshëm . Në vazhdim e paraqesim suksesin e nxënësve dhe mungesat në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025

Nr	Niveli Arsimor	Shkëlq.	Sh.mire	Mirë	Mjaf.	Me një e më shumë nota të dobëta	Të pa notuar	Gjithsej
1	Arsimi Fillor	2373	1234	1076	305	804	56	5848
2	Arsimi i mesëm	323	410	270	39	748	5	1795
	Gjithsej	2696	1644	1346	344	1552	61	7643

- **Suksesi i paraqitur në formë skematike**



- Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi ngritje të suksesit (kalueshmërisë) për 1% në të gjitha nivelet nga 79% në 80 %

Kuadri : Në bazë të të dhënave të SMIA të muajit Mars 2025 në arsimin parafillor, fillor, mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë të angazhuar 1003 punëtorë, shih tab.

Nr	Programi arsimor	Personeli			Gjithsej personeli 2024/2025
		Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli mirembajtes	
1	Çerdhja “Flutura” Suhareke	29	2	12	43
2	Shkolla fillore, e mesme e ulët	617	49	90	756
3	Shkolla e mesme e lartë	171	9	24	204
	Gjithsej	817	60	126	1003

Vlerësimi i jashtëm i njohurive të nxënësve

(Vlersimi PISA ,Testi i arritshmërisë-kl. 9,Testi i maturës-12,

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me MASHTI janë në proces të realizimit të vlerësimeve të njohurive të nxënësve dhe i kanë bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e vlerësimeve të jashtme të njohurive të nxënësve dhe të vlerësimit të brendshëm të njohurive të nxënësve :

- **Vlerësimet e jashtme në nivel vendi :**

-Testi i arritshmërisë – kl.9 dhe
-Testi i maturës- kl.12

- **Vlerësimeve ndërkombëtare :**
-Vlerësimi PISA

Testi “PISA 2025” -Bazuar në kërkesat e MASHTI-t, Drejtoria e Arsimit ka bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e e projektit “ PISA 2025” për të gjithë nxënësit 15 vjeçar të të gjitha shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të komunës sonë. Kriteret për përfshirje të nxënësve në PISA kanë qenë: nxënësit e lindur nga 01.01.2009 dhe 31.12.2009. Nga gjithsej nx. 15 vjeçar të komunës sonë janë përzgjedhur 219 nxënës për t`iu nënshtruar këtij testi. Testimi “ PISA 2025” i cili është realizuar në muajin maj dhe janë përfshirë tri shkollat e

mesme të larta : Gjinnazi ” Jeta e re “, SHP” Abdyl Ramaj”- Shirokë dhe SHMT “ Skender Luarasi ” si dhe katër SHFMU “ Dëshmorët e Kombit”-Vraniq, SHFMU “ Naum Veqilharxhi”-Mohlan, SHFMU ”Drita”-Gelancë dhe SHFMU “Xhavit Sylaj”-Sllapuzhan.

Matura 2025 - Bazuar në Ligjin mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018 , UA 05/2016 -Detyrat dhe përgjegjësitë e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit dhe Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit (MASHTI) nr. 01/008 të datës 25.02.2025 janë ndërmarr të gjitha masat që të realizohet ky proces. Shkollat dhe DKA janë angazhuar për të bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e testit të maturës 2025. Aplikimi për paraqitjen e testit është bërë përmes platformës E-Kosova

Bazuar në të dhënat e shkollave, 564 maturantë e kane paraqit Provimin e maturës përmes platformës E-Kosova dhe iu nënshtruan Provimit të Maturës shtetërore 2025, me datë 21.06.2025 duke filluar në ora 10.00 Testi është planifikuar dhe mbajtur në 4 objekte shkollore përkatësisht në 6 qendra te testimit.

Testi i arritshmërisë-kl. 9 -Komuna e Suharekës do të organizoi Testin e arritshmërisë për klasat e IX-ta sipas planifikimeve të MASHTI-it, DKA dhe shkollat janë duke i bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarëvajtje e këtij procesi. Bazuar në të dhënat e shkollave 654 nxënës pritet t'i nënshtrohen testit të arritshmërisë me datë 27.06.2025 duke filluar në ora 10.00. Testi është planifikuar të mbahet në 3 objekte shkollore përkatësisht në 5 qendra te testimit.

Vizitat e realizuara në shkolla

DKA me qëllim të avancimit të punës në institucionet shkollore ka planifikuar vizitat e rregullta dhe vizita speciale në shkolla për kontrollimin e mbarëvajtjes se procesit edukativo-arsimor,mirëmbajtja e dokumentacionit pedagogjik-administrativ mirëmbajtja e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm dhe sigurinë shkolla:

Për të gjitha shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta janë hartuar Procesverbalet e incizimit të gjendjes së bashku me rekomandimet për të eliminuara lëshimet e konstatuara.

Vlerësimi i performancës së drejtorëve /zëvendës drejtorëve te shkollave

Në bazë të UA-106/2020, DKA e ka formuar komisionin për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave për periudhën e punës katërvjeçare. Komisioni prioritet për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorët të cilëve iu përfundonte mandati(kontrata e punës) , e që në këtë periudhë tremujore është vlerësuar performanca e drejtorit të SHFMU “Shkëndija” në Suharekë dhe SHFMU “H. Prishtina “ në Semetisht

Vlerësimi i brendshëm i performancës së mësimdhënësve

Me vendim të MASHTI nr.01b/041,datë 29.04.2024 është miratuar udhëzuesi për vlerësim të performancës së mësimdhënësve për ripërtitjen e licencës se karrierës i cili bazohet në:

1. Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënies në Kosovë
 2. Ua nr. 14/ 2023 të MASHTI–për sistemin e licensimit dhe karrirën në mësimdhënie
 3. Ua nr. 15 /2023 të MASHTI–për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve
- Sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve përbëhet nga vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i brendshëm i referohet procesit të:

- Vetëvlerësimi,
 - Vlerësimi nga mësimdhënësit,
 - Vlerësimi nga drejtori i shkollës, dhe
 - Vlerësimi nga nxënësit.
 - Procesi i vpm të brendshëm, bazohet në kapacitetet e shkollës me besimin dhe bindjen se shkollat tashmë kanë udhëheqje të përgjegjshme dhe profesionale për administrim të këtij procesi, si dhe mësimdhënësit kanë kapacitetet e nevojshme për realizimin e tij. Drejtori është përgjegjës të udhëheqë dhe të administrojë tërë procesin e vpm të brendshme për secilin mësimdhënë të shkollës.
- Për realizimin e këtij procesi DKA i ka përgatitur të gjitha informatat dhe udhëzuesit për mbarrëvajtje vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.

Licencimi i mësimdhënësve dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Nga informatat e shkollave rezulton se deri më tani e kanë ripërtërirë licencën një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve dhe procesi po vazhdon me sukses.

Bursat për nxënës dhe studentë në vitin shkollor 2024/2025

Drejtoria Komunale e Arsimit me autorizimin e kryetarit të komunës ka shpallur konkursin për ndarjen e bursave për vitin shkollor 2024/2025, me nr. 05-nr.016-2813

Konkursi është shpallur në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës 01 nr.104-70025 të datës 26.12.2024.

Në bazë të vendimit për ndryshim–plotësimin 014r. 410-7438 me date 30.01.2025 dhe vendimit 01-nr.016-6358, të dt. 28.01. 2022 të Asamblesë komunale është formuar komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës.

Në këtë konkurs kanë aplikuar 383 nxënës (F-259 M-124) dhe 358 studentë (F-278 M- 80).

Komisioni duke u bazuar në Rregulloren për ndarjen e bursave, ka ndarë 240 bursa për studentë (F-189 M-51)dhe 110 bursa për nxënës (F-278 M-80) për vitin shkollor 2024/2025. Vlen të theksohet se Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bursa për nxënës dhe studentë në mënyrë decitive ka respektuar Rregulloren për ndarjen e bursave për vitin shkollor

Garat, aktivitetet e lira dhe aktivitetet jashtëmësimore në periudhën janar – mars 2025

- **Garat në fushën e fizikës:** Në fillimin e vitit të ri kalendarik 2025 kemi startuar me realizimin e garave komunale në fushën e fizikës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shoqaten e fizicientëve të rinj , ku katër vendet e para kanë përfaqësuar komunën tonë në garat në nivel republikan
- Raport i garave të matematikës në nivel komunal dhe republikan
- **Garat e matematikës :**Në muajin mars në objektin e IAAP "Abdyl Ramaj" – Suharekë, u mbajt me sukses Gara Ndërkombëtare e Matematikës “Kangaroo Kosova 2025” për regjionin e Prizrenit. Me pjesëmarrjen e nxënësve të talentuar dhe mbështetjen e Komunës së Suharekës, Institutit ATOMI, MASHT dhe shkollave pjesëmarrëse, kjo garë u zhvillua në një atmosferë inspiruese për të gjithë dashamirësit e matematikës. Nga Suhareka pjesëmarrëse ishin nxënësit nga klasa e parë deri në të nëntën nga SHFMU “Destan Bajraktari” Suharekë ,SHFMU “7 Marsi” Suharekë dhe SHFMU “28 Nëntori” Dobërdelan,SHFMU” Lidhja e Prizrenit” Budakovë,SHFMU “ Kongresi Manastirit” Studenqan,SHFMU” Shkëndija “Suharekë, SHFMU “Edit Durham “Mushtish, SHFMU”V. P. Shkodrani” Leshan, SHFMU “17 Shkurti” Shirokë dhe SHFMU “Ramë Bllaca” Bllacë



- **Pi Day në Suharekë**; Suhareka festoi Ditën e Matematikës me një aktivitet të jashtëzakonshëm, ku **kreativiteti dhe logjika** u bashkuan për të frymëzuar brezat e rinj! **Nxënësit nga shkollat e komunës sone** prezantuan **projekte inovative** para mësimeve, mysafirëve të nderuar dhe **profesorëve nga SHBA dhe Gjermania**, duke treguar se **matematika nuk është thjesht numra – është një gjuhë universale e zbulimit dhe inovacionit!** Pjesë e kësaj dite të veçantë ishte edhe **Koncerti Duo nga artistët: Ledian Shala dhe**

Agron Shujaku, të cilët e bënë atmosferën edhe më magjike. Ky aktivitet u realizua falë bashkëpunimit të **Drejtorisë së Arsimit, Shtëpisë së Fëllbahut, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit** si dhe përkushtimit të **mësimeve të matematikës**, të cilët inkurajojnë çdo ditë **mendimin kritik dhe kreativ!**

Garat e gjuhës shqipe në nivel komunal dhe republikan

Në mbështetje të Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës dhe vendimit të përbashkët për realizimin e Olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe për klasën e 9-të, për vitin shkollor 2024-2025 (Kosovë – Shqipëri), në komunën Suharekë u realizua testi i Olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe për klasën e 9-të në nivel shkolle ku morën pjesë 413 nxënës dhe më pas u realizua testimi në nivel komunal ku gjithsej 84 nxënës të cilët kaluan fazën e parë janë përfshirë në testim. Lidhur me këtë aktivitet nga DKA janë formuar komisione për hartimin e dhe vlerësimin e testeve dhe besojmë në realizimin me suksese të kësaj olimpiade edhe në fazat në vijim. Nxënësit fitues nga kjo garë do të jenë pjesë e garës në nivel republikan dhe pas rezultateve të garës komunale, nxënësit fitues të cilët kaluan 65% e totalit të pikëve, do të përfaqësojnë komunën tone në garat Republikane ku të zgjedhurit nga gara republikane do të përfaqësojnë Republikën e Kosovës në garat mes dy shteteve Kosovë-Shqipëri.

Lista e nxënësve për Olimpiadën e Gjuhës Shqipe, faza e tretë (niveli republikan)

Lista e nxënësve për Olimpiadën e Gjuhës shqipe, faza e tretë (niveli republikan)						
1	“RamëBllaca” - Bllacë	Elsa	Afrim	Pirku	37	74%
2	Dëshmorët e Kombit-Vraniq	Eliona	Betim	Basha	36.5	73%
3	Shkëndija- Suharekë	Learta	Shukri	Tërshani	36	72%
4	Shkëndija-Suharekë	Diona	Rrahman	Ramaj	35.5	71%
5	DestanBajraktari-Suharekë	Era	Astrit	Gashi	35	70%
6	DestanBajraktari-Suharekë	Era	Safet	Guri	34	68%
7	DestanBajraktari-Suharekë	Veron	Fatmir	Gashi	33.5	67%
8	28 Nëntori-Doberdelan	Dren	Bajram	Balaj	32.5	65%



Siguria në shkolla

Drejtorja Komunale e Arsimit i ka marr të gjitha masat për krijimin e një klime sa më të mirë në të gjitha institucionet shkollore duke pasur parasysh që nxënësit një pjesë shumë të madhe të kohës e kalojnë në ambientet shkollore dhe është shumë e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien e tyre po edhe për vetë procesin edukativo-arsimor, të ketë siguri të lartë në shkollë.

Konkurset

DKA ka pranuar përmes intranetit gjithsej 1,106 lëndë prej tyre të miratuara 574,refuzuara 511,në proces 21 Janë shpallur këto konkurse:

- Shtatë konkurse për mësimdhënës të cilat janë përfunduar me sukses,përveç një konkursi për lëndën e matematikës i cili ka dështuar në mungesë të kandidatëve .
- Dy konkurse për drejtor shkolle- Drejtor në SHFMU Xhavit Sylaj” në Sllapuzhan i cili është anuluar në mungesë të kandidatëve të kualifikuar dhe konkursi për drejtor në SHFMU”Dituria”Samadaraxhë i cili është ende në procedure.
- Dy konkurs për asistent për FNV të cilët janë anuluar pasi që nuk ka pasur kandidate të kualifikuar,
- Një konkurs për sekretar shkolle.
- Një konkurs për punëtor teknik-mirëmbajtës i cili është përfunduar me sukses.

Pensionime: Gjatë kësaj periudhe janë pensionuar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) punëtor **Pushime të lehonisë** :Në pushim të lehonisë janë njëmbëdhjetë (11) punëtore

Buxheti /Financat

- Hartimi i buxhet të DKA-së dhe shkollave për vitin 2026 dhe parashikimi për vitin 2027, 2028. Hartimi i buxhetit sipas qarkores buxhetore 2026/01 duket si në tabelë:

Instituci on	Paga dhe shitesa	Mallra dhe shërbim	Komunal i	Subvenci one	Pasuri jo financ.	Mallra dhe shërbime nga THV	Shp.Ko munale nga THV	Subven cione nga THV	Pasurit jo financia re THV	Gjithsej
DKA	103373	200000	30000	100000	540000	150000	30000	11000	0	1233373
Çerdhja	371295	52500	8000			22000				453795
Arsimi Fillor	7107025	502838	60000		59227	5000	20000			7784094
Arsimi i mesëm	1926006	167056	20000			10000	8000			2131062
Gjithsej	9507703	922394	118000	100000	599227	187000	58000	11000	0	11,572,324

Nga tabela konstatohet se buxheti i hartuar për vitin 2026 është 11,572,324.00€.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



- Pas procesit të alokimit në SIMFK nga ana e Thesarit apo aprovimit të “Planit të Keshit” kemi bërë regjistrimin e nën alokimeve për nivelin e nën programeve nga FB 10 për mallra, shërbime dhe komunal, si në tabelën:

Nr	Niveli Arsimor	Mallra dhe shërbime	Komunali
1	Arsimi Pra Fillor	18884	2500
2	Arsimi Fillor	183447	38660
3	Arsimi i mesëm	80005	11000
Gjithsej		282336	52160
Gjithsej nën alokime për 6 mujor		334,496.00	


Procesi i Nën Alokimeve është realizuar në tërësi për secilën shkollë. Çdo muaj kemi kryer procesin e transferit nga periudhat (muajt) e kaluara.

Takime të rëndësishme të DKA-së

- Takimet e rregullta javore konsultative të drejtorëve komunal me kryetarin e komunës
- Takime pune me inspektorët e arsimit të SIA-së në Prizren
- Takimet zyrtare në MASHT
- Takimet në asamblenë komunale
- Takimet javore me stafin e DKA-së
- Takimet mujore me drejtorët e shkollave.
- Takime të ndryshme me organizata dhe donatorë për realizimin e projekteve për ngritjen e cilësisë në arsim.

Objektivat për periudhën e ardhshme

- Ngritja e suksesit të nxënësve për periudhën e ardhshme dhe zvogëlimi i numrit të mungesave
- Shpallja e konkursit dhe pranimi i kuadrit në bazë të normativit për pranim të kuadrit.
- Pajisja e shkollave me mjete mësimor.
- Rregullimi dhe meremetimi i objekteve shkollore me prioritet.
- Vizitë- monitorim dhe kontroll sipas planifikimit dhe nevoja të shkollave.



RAPORT GJASHTËMUJORË JANAR - QERSHOR

2025

Drejtor i Drejtorisë
Visar KUÇI

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimi dhe Mjedisit gjatë këtij gjashtëmujori ka zhvilluar veprimtari të rëndësishme në funksion të planifikimit të territorit, administrimit të lejeve ndërtimore si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kjo drejtori karakterizohet nga: Hartimi dhe zbatimi i planeve zhvillimore, kontrolli urbanistik dhe ndërtimor, mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i dokumentacionit teknik, zhvillimi i qëndrueshëm dhe shërbimi ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025



Me datë 08.01.2025 u mbajt takim pune për rregulloren e bonuseve të zonimit me grupin punues dhe zyrtarët e drejtorisë ku qëllimi i këtij takimi ishte që kjo rregullore të mundësoj përdorimin e mekanizmit të bonuseve të zonimit si mjet zhvillimor. Përmes kësaj rregullore synojmë të krijojmë një balancë të drejtë mes interes publik dhe privat, duke mundësuar zhvillim të qëndrueshëm urban dhe përfitime konkrete për komunitetin.

Me datën 22.01.2025 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis në përbërje nga Drejtori i Drejtorisë (Menaxher i projektit) dhe koordinatori i projektit kanë organizuar takimin e parë me Ekipin Komunal për Planifikim të Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhel” dhe Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë” si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik INSI (Instituti për Teknologji dhe Shkencë) ku u bë prezantimi i skenarëve, vizioni, qëllimet, objektivat strategjike për Planin Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike në Duhel. Të pranishëm në takim kanë qenë edhe zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe kryetari i Komunës së Suharekës z.Bali Muharremaj.

Qëllimi i takimit të mbajtur kryesisht ishte prezantimi i tre draft skenarëve për Zonën Ekonomike në Duhel. Nga ekipi dhe nga zyrtarët e DUPM-së u tregua interesim i jashtëzakonshëm për këtë planë rregullues pasi që do të jetë qendra e dytë e Zhvillimit Ekonomik për vendin pas asaj të Zonës Industriale në Shirokë.



Në muajin shkurt për herë të parë në Komunën e Suharekës ka filluar vendosja e numrave zyrtarë në adresat tona, ku do të vendosen 20475 numra, për 1436 rrugë të regjistruara në Sistemin e Unifikuar të Adresave.



Sistemi i unifikuar i adresave është një sistem kombëtar apo lokal i ndërtuar për të siguruar identifikim të saktë, unik dhe të standardizuar të çdo ndërtese, parcele apo vendbanimi nëpërmjet emërimit dhe numërimit të rrugëve, hyrjeve

dhe objekteve. Ky system është i domosdoshëm për funksionim efikas të shërbimeve publike si posta, emergjencat, regjistrat civilë, urbanizmi dhe pronësia.



Në prezencë të ekspertëve të planifikimit nga shtetet e BE-së – Holanda, Italia, Sllovakia dhe Kroacia – së bashku me Departamentin e Planifikimit, Institutin e Planifikimit nga MMPHI dhe disa nga komunat e Kosovës, drejtori i DUPM-së Visar Kuçi prezantoi Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartën Zonale Komunale (HZK), si dhe digjitalizimin e tyre. Komuna jonë është e vetmja në Kosovë dhe rajon që ka digjitalizuar dhe i ka të publikuar online këto dokumente.

Gjithashtu, prezantoi përparësitë e këtyre dokumenteve dhe sfidat që po kalojmë si ne si institucion. Ky takim u mbajt me 17 Mars.

Kurse me 19 Mars Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis me kërkesën e kryetarit të Komunës së Suharekës z.Bali Muharremaj dhe Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis (Menaxher i projektit) kanë organizuar prezantimin e dytë publik rreth procesit të Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhël” dhe Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë” ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e INSI-t, zyrtarët e DUPM-së, ekipi komunal i planifikimit të këtyre dy planeve dhe qytetarët e komunës së Suharekës.

Kryetari i Komunës së Suharekës, menaxheri i kontratës dhe përfaqësuesi i Insit kërkojnë nga qytetarët e pranishëm në takim, nga ekipi dhe nga zyrtarët e DUPM-së që të japin ide, të kërkojnë transparencë dhe të punojmë së bashku për të sjellë një të ardhme më të mirë.



Qëllimi kryesor i takimit ishte diskutim mbi hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e planeve rregulluese në përputhje me kërkesat e qytetareve, kërkesat ligjore dhe zhvillimin 6 qëndrueshëm urban/rural. Temat e diskutuara në këtë prezantim ishin:

- **Gjendja aktuale** e planeve rregulluese ku u prezantua situata ekzistuese e dokumenteve rregulluese dhe sfidat në zbatim,
- **Propozime për përmirësim** ku u diskutuan ndryshimet e nevojshme në planet ekzistuese dhe nevoja për hartimin e planit të ri,
- **Përfshirja e paleve të interesit**, u theksua rëndësia e përfshirjes së komunitetit dhe institucioneve relevante në procesin e planifikimit,
- **Afatet dhe përgjegjësitë** ku u caktuan detyra konkrete për hartimin dhe finalizimin e planeve rregulluese.



Me kërkesën e menaxherit të projektit njëkohësisht drejtor i drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe koordinatores së projektit u mbajt puntoria e radhës me datë 27.05.2025 dhe takim pune me datë 03.06.2025 me Ekipin Komunal të Planifikimit për Planin Rregullues të Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhël” dhe Planin Rregullues të Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë” me zyrtarët e DUPM-së si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik INSI (Instituti për Teknologji dhe Shkencë).

Ne këtë puntori u diskutua dhe u vendosen nga Ekipi Komunal i Planifikimit: Kufijtë e Zonës Ekonomike, Tipologjitë e përdorimit të tokës (industriale, komerciale, shërbime, etj.), Parametrat urbanistik (vija ndërtimore, vija rregullative, lartësitë, distancat, hapësirat e gjelbërta etj.) dhe Infrastruktura kryesore (rrugë, ujësjellës, kanalizim, energji). Poashtu u vendos që ky projekt plan të përgatitet për procedurat e shqyrtim publik.



Vlen të ceket që musafirët special gjatë këtij gjashtëmujori në zyret tona ishin fëmijët e nivelit parafillor të cilët i dhanë hijeshi dhe ngrohësi ambienteve tona të punës, ku edhe ata morën disa njohuri të vogla rreth proceseve tona.



Kryesisht kemi pranuar kërkesa për:

- a. Kushte Ndërtimore,
- b. Leje Ndërtimore,

- c. Leje Rrërimi,
- d. Leje Mjedisore,
- e. Shfrytëzim të Hapësires Publike,
- f. Përshkrim Parcele,
- g. Pëlqim në Parim,
- h. Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal,
- i. Emërtim i Rrugëve,
- j. Qasje në Dokumente Zyrtare si dhe
- k. Legalizim i Objekteve

8

DUPM është marrë me shqyrtimin e kërkesave të ndryshme. Gjatë periudhës kohore 01.01.2025 deri më 25.06.2025 kemi pranuar gjithsejt 188 lëndë të rregullta dhe janë përcjellë 349 shkresa dalëse, ndërsa në Legalizim janë pranuar gjithsejt 29 lëndë kurse janë përcjellë 116 shkresa dalëse.

Shkresat dalëse të DUPM-së:

- a. Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore,
- b. Aktvendim mbi Leje Rrërimi,
- c. Aktvendim mbi Leje Ndërtimore,
- d. Aktvendim mbi Leje Mjedisore,
- e. Pëlqim për Shfrytëzim të Hapësires Publike,
- f. Pëlqim në Parim dhe te Ndryshme,
- g. Njoftim për Pagesë për lëndë të ndryshme,
- h. Plotësim Lëndë për lëndë të ndryshme,
- i. Raporte,
- j. Njoftime të ndryshme,
- k. Përgjigje rreth Kërkesës,
- l. Refuzime të Ndryshme,
- m. Përshkrim Parcele,
- n. Çertifikatë Legalizimi,
- o. Listë e Pritjes,
- p. Regjistrim në Kadastër rreth kërkesave të Legalizimit.

Lënde të Rregullta

Lloji i Kërkesës:	Lëndë të Pranuara	Të Aprovuara:	Të Refuzuara	Në Proces
Leje Rrërimi:	03	03	/	/
Kushte Ndërtimore:	27	10	06	13
Leje Ndërtimore:	12	05	/	06
Leje Mjedisore:	10	07	(1-Tërheqje nga Procedura)	02
Përshkrim Parcele:	05	04	(Përgjigje në Kërkesë)	/
Shfrytëzim i Hapësires Publike:	39	18	06 (1-Njoftim)	14
Çertifikatë e Përdorimit	01	/	/	01
Të Tjera:	Të tjera: 92	302 (shkresa dalëse)	/	-

Lëndet e Legalizimit

Lloji i Kërkesës:	Lëndë të Pranuara	Të Aprovuara:	Të Refuzuara	Në Proces
Çertifikatë Legalizimi:	29	42	/	
Listë e Pritjes:	-	04	-	-
Plotësim Lënde:	-	13	-	-
Njoftim për Pagesë:	-	12	-	-
Njoftim për Kadastër:	-	40	-	-
Njoftim për Legalizim:	-	05	/	/

Barazimi i të Hyrave Financiare për periudhën Janar – Qershor 2025

Muaji	Vlera:
Janar	62,103.37
Shkurt	23,221.32
Mars	15,212.98
Prill	63,478.24
Maj	12,825.53
Qershor	5,055.2
TOTALI:	181,896.64

Kushtet ndërtimore për gjashtëmujorin e parë

			KOMUNA E SUHAREKËS MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA					DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MJEDIS DIRECTORATE FOR URBANISM, PLANING AND ENVIRONMENT			A: Rr. "Brigada 123" Suharekë 23000, Republika e Kosovës Tel: 029/271-318 Tel: 045/879-202 E: urbanizmisuhareke@rks-gov.net		
KUSHTET NDËRTIMORE 2025													
Nr.	Emri dhe Mbiemri i	Vëndi	Nr. i referencës së Kërkesës	Lloji i kërkesës	Lloji i ndërtimit	Etazhiet	Kategoria e ndërtimit	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Nr. i referencës së Zgjidhjes	Mënyra e Zgjidhjes	Zyrtari i lëndës	
1	Sabit Selimi	Duhël	07Nr.350-66097 dt.28.01.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria I	01330-6	ZK Duhël	07Nr.34/350-66097 dt.28.01.2025	Kushte Ndërtimore	B.Sh	
2	"Design Lift's"-Sh.P.K	Suharekë	07Nr.350-70910 dt.30.12.2024	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1	Kategoria II	00151-1	ZK Reshtan	07Nr.37/350-70910 dt.29.01.2025	Kushte Ndërtimore	A.S	
3	Këshilli i Bashkësisë Islame"-Sami Hoxha	Suharekë	07Nr.350-5923 dt.23.01.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria II	03609-0	ZK Bllacë	07Nr.57/350-5923 dt.07.02.2025	Kushte Ndërtimore	B.Sh	
4	DKA-Remzi	Suharekë	07Nr.350-5936 dt.23.01.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	PL	Kategoria II	00648-1 dhe 00648-2	ZK Bukosh	07Nr.72/350-5936 dt.19.02.2025	Kushte Ndërtimore	D.B	
5	Bajram Elshani	Suharekë	07Nr.350-2277 dt.10.01.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+2	Kategoria II	02912-0	ZK Suharekë	07Nr.118/350-2277 dt.07.03.2025	Kushte Ndërtimore	A.S	
6	"Mala Metal"-Sh.P.K-Faton Malaj	Suharekë	07Nr.350-10550 dt.19.02.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	PI	Kategoria II	00729-1	ZK Mushtisht	07Nr.170/350-10550 dt.03.04.2025	Kushte Ndërtimore	E.K	
7	"Gjini Construction"-Sh.P.K	Suharekë	07Nr.350-20620 dt.07.04.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+1 dhe P+2	Kategoria I	00401-22 dhe 00401-28	ZK Suharekë	07Nr.193/350-20620 dt.16.04.2025	Kushte Ndërtimore	B.Sh	
8	"Capital-Invest"-Sh.P.K	Suharekë	07Nr.350-30619 dt.26.05.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7	Kategoria II	01971-0, 01970-3, 01970-2, 01970-1, 1969-2, 1969-1 dhe 01947-4	ZK Suharekë	07Nr.325/350-30619 dt.12.06.2025	Kushte Ndërtimore	B.Sh	
9	"Arbëria Turist"-Sh.P.K-Afrim Balaj	Suharekë	07Nr.350-26005 dt.05.05.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	B+P+7 dhe B+P	Kategoria II	2806-0, 1612-1, 1612-2, 1607-1, 1608-1, 1608-2, 1607-2, dhe 1606-0	ZK Suharekë	07Nr.330/350-26005 dt.16.06.2025	Kushte Ndërtimore	E.K	
10	"Jetimat e Ballkanit"-Ardit Gashi	Gjinoc	07Nr.350-30617 dt.26.05.2025	Kushte Ndërtimore	Ndërtim i Ri	P+Nk	Kategoria II	00061-0	ZK Gelanecë	07Nr.334/350-30617 dt.17.06.2025	Kushte Ndërtimore	B.Sh	

Lejet ndërtimore për gjashtëmujorin e parë

Komuna e Suharekës - Drejtoria e Urbanizmit - Lejet e lëshuara 2025

Qytetarë të nderuar, këtu i keni të gjitha lejet e lëshuara për vitin 2025. Nëse nuk gjendet ndonjë leje në këtë tabelë, atëherë ndërtimi për të cilin ju intereson nuk ka leje ose është në proces të lejës.

Koment:Të gjitha Lejet e Lëshuara prej dt. 01.01.2023 janë llogaritur në bazë të Rregullores së re mbi Taksën Administrative për dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifen për rregullimin e Infrastrukturas Komuna e Suharekës - Drejtoria e Urbanizmit - Lejet e lëshuara 2025

	Data e aplikimit të lejes	Data e lëshimit të lejes	Pronari / Pronarët (Përfaqësuesi)	Kompania / Investitori	Projektuesi	Zona Kadastrale	Sipërfaqja totale ndërtimore në m²	Pagesa e tarifës për rritjen e densitetit 1.80 € (K-I), 1.80 € (K-II)	Pagesa e taksës administrative 2.40 € (K-I), 2.80 € (K-II)	Pagesa totale e lejes së lëshuar	Etazhiteti i objektit	Destinimi i objektit	Dokumenti në PDF i lejes së lëshuar	A ka marrë aplikuesi Kushte ndërtimore se pari (apo ka aplikuar drejteperdrejte për leje ndërtimore)
1	27.11.2024	23.01.2025	Driton Gashi	N.T.P "Fat Mani"-Driton Gashi	"95 Studio"	Studençan	360.00	/	/	/	P+0	Ndërtim i Ri-Leje e Përkohshme		Po
2	29.11.2024	28.02.2025	Visar, Naser, Muhamet dhe Negjat Basha	Visar, Naser, Muhamet dhe Negjat Basha	"Urbhomes"	Suharekë	12,442.15	14,451.32	47,607.06	62,058.37	B+P+4 dhe 2B+P+4	Ndërtim i Ri-Ndertesë në varg-Lamela 1,2 dhe 3		Po
3	02.12.2024	06.03.2025	Elena Kuçi	"Ben Center" & "Ada Group"-Sh.A-Elena Kuçi	"Outline"-Sh.P.K;"Arm Ing"	Suharekë	2,977.80	/	/	9,023.73	P+1	Ndërtim i Ri-Fabrikë për përpunimin e produkteve ushqimore		Po
4	06.03.2025	08.04.2025	Sabit Selimi	Sabit Selimi	"Urbhomes"	Duhël	134	/	/	321.60	P+0			Po
5	27.11.2024	07.04.2025	Nazim Kryeziu Bajram Sopa dhe Florim Gashi	Nazim Kryeziu	"Vm Architects"-Sh.P.K	Suharekë	2,248.39	1,891.35	8,491.01	10,382.36	B+P+4	Ndërtim i Ri-Objekt afarist banesor, ndërtësia dyshë		Po
6	09.01.2025	10.04.2025	Soga L.L.C-Bajram Sopa dhe Florim Gashi	Soga L.L.C-Bajram Sopa dhe Florim Gashi	"Point Construction"	Delloç	1,297.00	/	/	3,632.44	P+0	Ndërtim i Ri-Leje e Përkohshme		Po
7	15.11.2024	16.04.2025	Armend Kuçi	"Tirolspan"-Sh.P.K-Armend Kuçi	"Kicplann"-Sh.P.K	ZK Suharekë	1,631.00	/	/	4,566.80	P+0	Ndërtim i Ri-Fabrikë për përpunimin e		Po
8	10.04.2025	18.04.2025	Bajselmani	DKA-Remzi Bajselmani	"Inno Group"-Sh.P.K	ZK Bukosh I	677.74	/	/	/	PL	Ndërtim i Ri-Objekt Rekreativ-Sportiv		Po
9	06.03.2025	22.04.2025	Blerim Bajraktari	"Immoland"-Sh.P.K-Blerim Bajraktari	"Immoland"-Sh.P.K	ZK Suharekë	4,252.50	4,314.02	16,739.80	21,053.82	2B+P+7	Ndertesë në kuadër të bllokut ndërtimor		Po
10	17.10.2024	17.04.2025	"Gjini Construction"-Sh.P.K	"Gjini Construction"-Sh.P.K	"Green Project Studio"-Sh.P.K	ZK Suharekë	253.8	313.47	609.12	922.59	P+1	Ndërtim i Ri-Objekt Individual me një njësi banimore		Po
11	17.10.2024	17.04.2025	"Gjini Construction"-Sh.P.K	"Gjini Construction"-Sh.P.K	"Green Project Studio"-Sh.P.K	ZK Suharekë	253.8	313.47	609.12	922.59	P+1	Ndërtim i Ri-Objekt Individual me një njësi banimore		Po
12	17.03.2025	05.05.2025	Këshilli i Bashkësisë Islame	"Këshilli i Bashkësisë Islame"-Sami Hoxha	"Pro Architecture"	ZK Bllacë	200	/	/	/	P+MF	Ndërtim i Ri, Objekt i veçantë-Xhami		Po

Përmbajtja:

- Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale funksionojnë 3, (tre) sektorë si vijon;
 - SEKTORI I SHËNDETËSISË
 - QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE “REXHEP KUQI”
 - SEKTORI I MIRËQENIES SOCIALE
- **Departamenti i Administratës së Sektorit të shëndetësisë:**
 - Drejtori i DSHMS-së
 - Zyra e Udhëheqësit
 - Zyra Ligjore
 - Zyra për buxhet dhe financa
 - Zyra për qeshtje Administrative
- Aktivitete kryesore në DSHMS
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqeni Sociale, do të jetë përgjegjëse për këto detyra;
 - hartimin e strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, edukimin shëndetësor, imunizimin;
 - monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës për ti identifikuar, analizuar shkaqet dhe zgjidhur në kohë problemet dhe rreziqet për shëndetin e popullatës;
 - zhvillimin e politikave dhe planeve që mbështesin përpjekjet shëndetësore të individit dhe komunitet në përgjithësi;
 - informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës rreth çështjeve shëndetësore dhe shëndetit publik;
 - kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari;
 - të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke iu përmbajtur udhëzimeve nga MSH;
 - siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
 - raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendit të Komunës;
 - zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që i lëshon MSH dhe Kuvendi i Komunës;
 - e drejta për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës;
 - monitorimi dhe bashkëpunimi me QPS në Komunë rreth përkujdesjes së rasteve sociale të popullatës së Komunës;

- bashkëpunon me MSH, vendos dhe zbaton politikat e mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS, në nivelin lokal;
- mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në nivel të komunës;
- koordinimi dhe mbikëqyrja e punës së QKMF, QMF dhe ambulancave dhe Qendrës për Punë Sociale;
- vendos dhe mbledh bashkë-pagesat, propozon që t'i vendosë lirimet për shërbime ndaj qytetarëve nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin aplikativ;
- marrja e hapave për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare, brenda territorit të Komunës;
- përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- bënë kontrollimin dhe inspektimin në lëmin e sanitarisë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;
- do t'i ushtroj edhe kompetencat tjera që dalin nga ligjet e veçanta, statut të komunës, akte nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësit në Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës 01.01.2025 deri me 25.06.2025, janë kryer këto shërbime:

Nr.	Emertimi i punëve të kryera	Gjithësejë
1.	Shkresa të ndryshme si: njoftime, kërkesa, përgjigje, etj.	51
2.	Referenca pune	1
3.	Formular për botën e jashtme.	817
4.	Kërkesa për ndihmë momentale të miratuara.	270
5.	Formular për vazhdim të pensioneve	20
6.	Kërkesa për subvencione të lindjes të miratuara	3
7.	Raport finciar për tri programet buxhetore	3
8.	Raport për faturat e pa paguara për tri programe tbuxhetore	6
9	Kërkesa për ndihmë momentale të refuzuara	17
10.	Përgaditja e lëndës për shpalljen e tenderit per DDD.	/

11.	Përgaditja e lëndës për shpalljen e tenderit pa projektin për skamnorët	1
12.	Vendim për ndihma momentale	4
13.	Përgaditja e lëndëve për pagesë në DSHMS	169
14.	Shtesa për fëmijë	2
16.	Dëftesa për pagesa	661

Gjatë këtij tre mujori kemi pasur takime të rregullt me stafin, ku kemi diskutuar për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët të cilët marrin shërbime pranë DSHMS-së.

Drejtoresha së bashku me Udhëheqësin e sketorit të Shëndetësisë kanë vizituar Qendrën për Punë Sociale, ku janë takuar me udhëheqësin dhe zyrtarët e kësaj Qendre me të cilët kanë biseduar për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët, po ashtu sfidat me të cilat ballafaqohen ata në qdo ditë për shkak të natyrës së ndjeshme të punës që ata ofrojnë.

Po ashtu sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës janë hartuar edhe raporte mujore për zbatimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës dhe Bashkësisë Islame si dhe raporte mujore për zbatimin e Kontratës mes Komunës dhe HANDIKOS.

Gjatë Muajit Mars është nënshkruar edhe Marrëveshja mes Komunës së Suharekës dhe Banjës së Kllokotit, e cila marrëveshje ju mundëson shërbime qytetarëve të cilët plotësojnë kushtet për të qenë përfitues të këtyre shërbimeve .

Udhëheqësi i Sektorit të Shëndetësisë po ashtu sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës ka qenë pjesë e disa Komisioneve vlerësuese për konkurset të shpallura nga NJBNJ e Komunes.

Po ashtu me datë 17,18 dhe 19 Mars Drejtoresha së bashku me Dr. Betim Iballi, duke ju referuar detyrave të punës kanë mbajtur Ligjeratë me temën Parandalimi dhe trajtimi i dukurive negative si : duhani, alkooli dhe substancat narkotike, për nxënësit në Gjimnazin “Jeta e Re” , Shkolla e mesme “Skendet Luarasi” dhe Shkollen e mesme Profesionale “Abdyl Ramaj.

Me datë 19.03.2025 Drejtoresha e DSHMS-së ka pritur në takim zyrtaren nga Agjencia për ndihmë juridike falas zyra e së cilës gjendet në objektin e Qendrës për Punë Sociale, në këtë takim kanë diskutuar për marrjen e shërbimeve juridike falas nga qytetarët e cila është një mundësi shumë e mirë për shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve.

Drejtorja për Shëndetësi gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me Qendrën për punë Sociale dhe SOS –Fshatrat ka hartuar Draftin Komunal për Strehimin Familjarë për Komunën e Suharekës, gjatë këtij aktiviteti janë mbajtur disa takime mes akterëve profesional ku edhe në fund është bërë hartimi i këtij Drafti.

Sipas planifikimit buxhetor për vitin 2025 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me datë 27.05.2025 është bërë shpërndarja e 100 pakove ushqimore për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, pjesë e këtij aktiviteti ka qenë edhe Qendra për Punë Sociale e cila me kërkesën e DSHMS-së ka përpiluar listën e familjeve me gjendje të rëndë ekonomike.

Me datë 24.06.2025 Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale së bashku me Udhëheqësin e Sektorit për Shëndetësi kanë pritur në takim zyrtarët nga MAPL-ja dhe Organizatës Syri Vision, ku në këtë takim është diskutuar për hartimin e Planit të veprimit për fëmijët. Gjatë këtij takimi Drejtoresha e Shëndetësisë është shprehur se përkrahë në suaza të mundësive hartimin e këtij plani dhe se gjithmonë është e hapur për bashkëpunim, pasi që është në dobi të fëmijëve.

Deri më tani përmes Ndihmave Momentale kemi subvencionuar me mjete financiare 270 persona me sëmundje dhe gjendje të rëndë ekonomike në shumë prej 59,950.00 (pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntë qindë e pesëdhjetë) Euro, po ashtu kemi subvencionuar me rehabilitim në Banjë të Kllokotit 43 persona të cilët kanë plotësuar kushtet për të qenë përfitues..

Gjithashtu gjatë këtij gjashtë muji vazhdimisht kemi pasur kërkesa për ndihmë momentale, ne ju kemi ofruar vazhdimisht ndihmë si dhe ju kemi dhënë shqarime të nevojshme në mënyrë që aplikimi të jetë në rregull si dhe qështje tjera që ndërlidhen me punën e Drejtorisë së Shëndetësisë.

RAPORTI GJASHTË MUJOR

01.01.2025 - 25.06.2025

PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE

Gjatë kesaj periudhe nga data 01.01.2025- 25.06.2025 në Qendrën për Punë Sociale në Suharekë , në kuadër të shërbimeve Sociale dhe asistencës Sociale janë kryer këto shërbime:

Nr.	Përshkrimi i detyreave të punës	Rastet
1	Kërkesa për kontakt prind – fëmijë.	1
2	Kërkesa për vertetim që nuk iu është hequr zotësia e veprimit dhe nuk gjenden nën kujdestari për sigurimin e lejeve tëndryshme .	191
3	Kërkesa në Gjykata për mendimin për martesë të parakohëshme.	0
4	Kërkesë për regjistrim të më vonshëm të fëmijëve të mitur në LAL .	0
5	Kërkesa për lëshimin e deshmisë se nuk kan obligime finaciare ndaj personave përgjegjës para ligjit – për lirim nga shtetësia e Kosovës	12
6	Divizioni i Kundërvajtjes në Suharekë , kërkesa për mendimin për të miturit delikuent për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse si: vjedhje , prishje e rendit dhe qetësi , delikti në komunikacion etj.	10
7	Gjykata Komunale Suharekë, kërkesë për dhënjen e mendimit për ruajtje, besim dhe edukim për fëmijët e mitur.	12
	Kërkesa për vertetim për përkujdeje të fëmijëve të mitur Për të bërë bashkim familjarë prind – fëmijë .	2
8	Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policie (kanosje , shkelje e detyrimeve familjare)	0
	Gjykata Komunale në Suharekë , kërkesë për heqjen e zotësis së veprimit të semuarit mental – mendim.	1
9	Gjykata Komunale në Suharekë , kërkesë për dhënjen e mendimit për adoptim.	0
10	Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policor: Dhunë familjare.	7
11	Policia Regjionale në Prizren – Raport Policor: Dhunim.	0
12	Policia Regjionale në Prizren – Raport Policor: Ngacmim Seksual .	1
13	Stacioni Policor në Suharekë – Raport Polior: Tentim-vetëvrasje.	0
14	Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policor: Lendim i rendë trupor-vrasje.	0

15	Kërkesë për caktimin e kujdestarit për të mitur. 16	1
16	Referime interne nga personeli i QPS në Suharekë për asistencën sociale.	4
17	Kërkesë për vertetim që është i vetmi kujdestar- duke u përkujdesur për fëmijën e mitur.	6
18	Kërkesë për vërtetim për lëshimin e qartifikatës së bashkësisë familjare.	0
19	Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për të mitur – Mbikqyrje e shtuar nga ana e Organit të Kujdestarisë.	4
20	Kërkesë për vertetim që është person i vetmuar dhe i moshuar për të bërë bashkim familjar .	11
21	Kërkesë për vërtetim për rregullimin e pasaportës për të mitur .	6
22	Kërkesë për vërtetim për rregullimin e letërnjoftimit.	0
23	Kërkesë për fitimin e shtetësisë së Kosovës.	62
24	Kërkesë për zbatimin e procedurës për pajtim të bashkëshortëve	0
25	Pelqim për udhëtim jashtë vendit për të mitur.	3
26.	Kërkesë për rregullimin e shtesave	2

- Kërkesa për përkrahje materiale për familjen që kanë fëmijë

me aftësi të përhershme të kufizuar 5 raste

P.S : Prej 5 raste 1 është zgjidhur pozitivishtë

3 është zgjidhur negativishtë dhe

0 plotësim dokumentash

1 nuk është shqyrtuar akoma

Pjesëmarrja në seanca gjyqësore për përfaqësim 27 raste

Gjatë kësaj periudhes tre mujore nga data 26.03.2025 e deri me 24.06.2025 zyrtarët e shërbimeve sociale kanë kryer edhe shumë punë të tjera që janë në kontuitet të punës së tyre si vizitat e strehuesve rezidencial si vijon :

1. Qendra e Sigurt për Gra dhe Fëmijë në Prizren 2 raste
2. Në Entin Special në Shtime (tani janë vetem) 4 raste
3. Në “SOS Fshatin e Fëmijëve” në Prishtinë 6 raste
4. Në Shtëpinë për të moshuar në Prishtinë 1 raste
5. Në Strehim Familjar në Mushtisht 2 raste
6. Në Strehim në “ Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve” në Prishtinë
..... 0 raste
7. Braktisje e fëmijut të mitur 0 raste

- Vizita e fëmijëve me aftësi të përherëshme të kufizuara që duhet të vizitohen dy herë në vit për : 56 raste
 1. Gjendjen e përgjithëshme shëndetësore të fëmijës
 2. Se përkujdesja e fëmijës nga ana e familjës është
 3. Mjetet materiale të fëmijës shpenzohen vetem për fëmijën

-Vizita e fëmijëve në strehim familjar te të afërmit – 18 raste

ASISTENCA SOCIALE

Sa i takon Asistences Sociale gjatë këtyre gjashtë muajve të këtij viti pra nga 26.03.2025 deri me 24.06.2025 ka qenë në suaza të normales, kështu:

1. Janar 2025 në Asistencë Sociale	348 familje,
2. Shkurt 2025 në Asistencë Sociale	345 familje,
3. Mars 2025 në Asistencë Sociale	343 familje,
4. Prill 2025 në Asistencë Sociale	339 familje
5. Maj 2025 në Asistencë Sociale	340 familje
6. Qershor 2025 në Asistencë Sociale	327 familje

Gjatë këtyre tre muajve raste të reja kanë aplikuar për Asistencë Sociale ishin 10 raste të reja prej tyre 10 kane plotësuar kriterin për Asistencë Sociale pra si qe po shifet per çdo muaj kemi raste të reja që aplikojn. Po ashtu kemi 3 raste të cilat për mosriaplikim janë largue nga Asistenca Sociale.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Në bazë të urdhëresës së Kryetarit mbi raportin e punës 6 (gjashtë) mujor, nga data **03.01.2025-25.06.2025**, ku gjatë periudhës 6 (gjashtë) mujore kemi punuar si më poshtë :

Gjatë 6 (gjashtë) muajve të vitit 2025, në Sektorin e Shërbime Publike janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës së kësaj Drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme në këtë drejtori ishin:

- Si zakonisht në çdo ditë pune, bashkëpunimi dhe koordinimi me stafin e Drejtorisë për punët brenda ditës javës, muajit, dhe 6 (gjashtë) mujorit të parë të këtij viti, jemi marrur për shqyrtimin e kërkesave të ndryshme, si dhe nevojat Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

- Brenda këtyre gjashtë muajve me bashkëpunëtorë të Drejtorisë, kemi bërë edhe vizita në teren për kërkesa të ndryshme, si dhe shqyrtimi i tyre në teren, siç është fjala për (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë, rrymë, si dhe shumë kërkesa të ndryshme brenda Drejtorisë), por gjithmonë sipas kërkesave të qytetarëve, po ashtu edhe me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, Publike, dhe Emergjencë, dhe në fund kemi bërë raport me shkrim, dhe ku i kemi raportuar Drejtorit të DSHPE, si dhe Kryetarit dhe Drejtorive tjera në Komunë sipas nevojave të veqanta.

- Po ashtu takime të shpeshta me Drejtorin dhe bashkëpunëtorët e drejtorisë, si dhe me Menaxherët e projekteve për rregullimin dhe riparimin e ndriqimit Publik në komunën tonë.

- Përgaditja e raportit me shkrim për çdo muaj për kryerjen e pagesës, së konsulentit individual për efikasitet të energjisë.

- Kërkesat për zotime për çdo javë, muaj si dhe brenda 6 (gjashtë) muajve, për pagesa të ndryshme brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, si për investime kapitale, mallra dhe shërbime, për shpenzime komunale, si dhe pagesa të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Përgaditja e përformancës për ujësjellëse dhe kanalizime për vitin **2024** në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë, si dhe përgaditja për çdo vit me vendim të Kryetarit të Komunës.

- Inicimi si zakonisht i Procedurave për mallta dhe shërbime për vitin 2024, se sidomos në 6 (gjashtë) mujorin e parë, si dhe iniciime të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Inicimi si zakonisht i Procedurave të projekteve kapitale për vitin 2024, rrugë, kanalizime, trotuare, si dhe iniciime të ndryshme brenda Drejtorisë.

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale dhe mallrave dhe shërbimeve, si dhe kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat shpenzimeve komunale të Rrymës, Ujit, Telefonit, Mbeturinave.

- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.

- Kryerja e pagesave për punëtorët e zjarrefikësave dhe faturave të ndryshme për këtë sektor. - Inicimi i procedurave minimale me zyrën e Prokurimit, për nevojat e zjarrefikësave në kuadër të –DSHPME.

- Shpenzimi i Buxhetit me afatet e caktuara nga ZKF-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë tonë, si dhe shumë kërkesa tjera pranë Drejtorisë.

- Kontakte të shpeshta telefonike me Keds-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, PTK-në etj, për nevojat e Drejtorisë- Komunës, të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.

- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e Drejtorive dhe të Komunës.

- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre.

- Dhënja dhe pëlqimi i kërkesave për KEDS-in, si dhe bashkëpunime të shumta me ta.

- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione tjera.

- Përgaditja edhe menaxhimi i Planit të rrezikut të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Drejtorit dhe Kryetarit të Komunës.

- Përgaditja e planifikimit të buxhetit për çdo vit për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor financiar etj.

- Raportimi i raporteve mujore për çdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për mallra dhe Shërbime, për shpenzime Komunale, si dhe investime kapitale në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, duke i raportuar për çdo muaj, zyrtarit Kryesor Financiar të Drejtorisë për ekonomi dhe Financa.

- Kërkesa të shpeshta për ndryshime të faturave nga operatorët e ndryshëm, në bazë të kërkesës të cilën e bëjmë ne si Drejtori e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.

- Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre .

- Takime të shpeshta me stafin për qështje dhe punë të ndryshme brenda drejtorisë, po ashtu takime të shpeshta sipas kërkesës së Drejtorit në zyrën e tij për punët e Drejtorisë.

- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit, Drejtorinë e Arsimit (DKA), Drejtorinë e Administratës, e tjera) ,pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë , KEDS-in , dhe PTK-në etj.

1. Deri me tash kanë ardhur në drejtorinë 154 kërkesa të ndryshme (100%),

- 96 kërkesa janë miratuar apo 62.34 %,
- 50 janë refuzuar apo 32.47 %
- 8 sosh janë në proces apo 5.19 %.

2. Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit.

Vërejtje: Më posht po i paraqes mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit për vitin Qershor 2024-Qershor25

Pastrimi i rrugëve lokale, 247572 m'

Mirembajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve te ecjes dhe lapidarëve, 151350 m2

Pastrimi dhe mirembajtja e /hedhurinave ne varreza, 258333 m2

Mirembajtja e gjelbrimit ne parqe, sheshe, shtigje te ecjes dhe pergjate brezit rrugor, 311870 m2

Mirembajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (te perbashketa) ne objektet shumebanesore 384 cope

Ujitja e hapsirave publike ne Komunë, 23760 m2,

Largimi I mbeturinave shtazore, 265 copë.

Largimi dhe transporti i mbeturinave me vëllim 405.34 ton

Mirëmbajtja dhe pastrimi i shtratit te lumit në Suharekë, 3500m'

3. Në kuadër të projektit Mirëmbajtja e rrugëve lokale nga Bora, Operatori në fjalë ka mbajtur kujdestari, deri me tani nuk ka pasur nevoj per intervenime. Rruget janë të pastruar dhe të të kalueshme për qarkullim. Ku vlera perfundimater e sherbimeve per vitin 2024-2025 ka qenë 103,459.00 Eur.

- **Sektori për infrastrukturë**

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2025. Janë bërë fillimisht sistematizimi i dokumentacionit të vitit paraprak të projekteve, përgatitje të dokumentacioneve si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave, zotimi i mjeteve ku i kamë përgaditë kërkesat për pesëdhjetë (50) projekte të investime kapitale për vitin 2025. Po ashtu kamë përgaditë përgjigje në kërkesa të ndryshme për institucionet e ndryshme, komision për vlerësimin e tenderëve, komision profesional me aktvendim të Kryetarit të Komunës, përgatitje të raporteve në kuadër të drejtorisë si dhe procedimi i lëndëve për pagesë ,arkivim i dokumentacionit për projekte të realizuara si dhe punë tjeranë *kuadër të drejtorisë*.

-Projektet Kapitale për vitin fiskal 2025 të cilat janë përgaditë dokumentacionet si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave janë këto :

Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Nepërbisht, Grejkoc,Bllacë, Mushtisht dhe Komunë" Suharekë-Ritender

- 1) Ndertimi i zonave te gjelbruara dhe rekreative në Vraniq, Mushtisht, Studenqan e fshatra tjera dhe Suharekë.
- 2) Bllacë –Ndertimi i rrugëve lokale "Mehmet Lumi"-degëzim,"Martiret e Sukave"-degëzim, "Uniteti" ,Selim Ali Baku", "Alush Rexhepi"-degëzim,"Shkodra", "Ramadan Suka"-vazhdim,"Shtabi Ushtarak"-degëzim,"Valbona"-vazhdim "Kadri Qollaku"-degëzim dhe "Trimat"-degëzim .
- 3) Bukosh- Ndertimi i rrugëve lokale "Zylfije Sopa" dhe "Qamil Kadolli" ne Bukosh
- 4) [Doberdelan- Ndertimi i rrugëve: "Izet Shefketi" dhe "BajramIslami" ne Doberdelan](#)
- 5) Dubravë- Ndërtimi i rrugëve lokale "Jetish Limani"-vazhdim,"Haxhi Gashi"-segment,dhe "Kadri Ramadani"segment në Dubravë .
- 6) Dvoran- Ndertimi i rruges lokale "Qamet"-vazhdim ne Dvoran
- 7) Gjinoc- Ndërtimi i rrugëve lokale "Behlulaj ", "Ali Jupaj", "Mbreti Agron"-segment, "Lushnja"-segment "Theranda"-segment në Gjinoc
- 8) Greikoc- Ndërtimi i rrugëve lokale "Rahim Salihu", "Jemin Jashari", "e Safet Kica"-degëzim në Grejkoc .
- 9) Leshan- Ndërtimi i rrugëve lokale "Bashkim Kabashi" Ismet Kodra"-degëzim dhe "Dituria" në Leshan
- 10) Neperbisht- Ndertimi i rruges lokale e "Varrezave" në Nepërbisht
- 11) Sallagrazhdë-Ndertimi i rruges lokale "Mikel Nika" ne Sallagrazhdë
- 12) Samadrexhë Ndërtimi i rrugës "Gjallica", " Feim Morina"-segment,"5 Nëntori"-segment dhe "Nexhmedin Hoti"-segment në Samadraxhë
- 13) Savrovë- Ndertimi i rruges lokale -Rruga UÇK-se -vazhdim ne Savrove
- 14) Sopijë-Ndërtimi i rrugë velokale "Muharrem Balija"(Albert Mazreku)- segment,"Naum Vexhel harxhi"-segment "2 Prilli"(Ahmet Sadikaj)-segment "Salih Azizi"në Sopijë .
- 15) Studenqan-Ndërtimi i rrugëve lokale "Eqerem Qabej", "Arsim Gegaj" dhe "Gurra" në Studenqan .

16) Terrnje- Ndertimi i rruges lokale "Dajti"- vazhdim ne fshatin Terrnje

22

17) Vraniq- Ndërtimi i rrugëve lokale "Firajes" dhe "Matoshve " në Vraniq

18) Kryerja e shërbimit të zhvendosjes (merimangë) dhe bllokimit të automjeteve në teritorin e Komunës së Suharekës.

19) Breshanc-Ndertimi i rruges te varrezat "Parajsa" ne Breshanc

20) Nishor-Ndërtimi i rrugëve lokale "Shaqir Xheladini","Ramiz Ajeti",-segment,"Imer Bytyqi"-segment,rruga e vorrezave në lagjen "Kadriajaj", "Brinjët e Isarit"-vazhdim,"Rasim Ramadani", "Demaj"-vazhdim,"Tahir Ademi"dhe Rasim Emrushi"në Nishor .

21) Semetisht-Ndërtimi i rrugëve lokale "Ukë Bytyqi"-degëzim te shkolla dhe "Spitali I Luftës" në Semetisht .

22) Mushtisht- Ndërtimi i rrugëve lokale "Ushtari I UÇK-ës "-Aneks,"Qamil Mushtishti",- aneks", "Bafti Shala"- 2 anekse "Isak Shala" dhe "Rugova"-aneks në Mushtisht

23) Budakovë-Ndërtimi i rrugëve lokale "Furra e UÇK-së", "Ali Buqa"e "Sherif Buqa"në Budakovë

25) Krushicë e Eperme-Ndërtimi i rrugës lokale "Shtabi i UÇK-së"faza e parë në Krushicë e Eperme.

26) Krushicë e Poshtme-Ndërtimi i rrugës "lagjia e Gashëve" në Krushicë e Poshtme .

27) Maqitevë-Ndërtimi i rrugës kryesore "Hamzë Jashari" në Maqitevë .

28) Peqan-Ndërtimi i rrugëve lokale "Ili Konushevci-segment djathtas,"Ahmet Sefa",Emona ", "Muhamet Krasniqi" "Jashar Shasivar Bytyqi"në Peqan .

29) Popolan-Ndërtimi i rrugës lokale "Shaip Kolgeci"në Popolan.

30) Qadrak-Ndërtimi i rrugës lokale "Mehmet Tafolli"faza e parë në Qadrak.

31) Reqan-Ndërtimi i rrugës lokale "Te lapidari"në Reqan

32) Reshtan-Ndërtimi i rrugës lokale "Kadri Morina"në Reshtan

33) Suharekë-Ndertimi dhe rikonstruimi i rrugeve lokale "Milit Kryeziu", "Xhavit Bajraktari", Adem Kuqi", "Zekë Bajraktari", "Luigj Nikolla"-segment dhe "Aleksander Moisiu" në Suharekë .

34) Sllapuzhan- Ndërtimi i rrugës "Komandant Xhaviti "-segment dhe "Xhemajl Basha "-segment në Sllapuzhan .

35) Shirokë-Ndërtimi i rrugëve lokale "Hil Mosi", dhe "Tafolli" në Shirokë

36) Vërshec-Ndërtimi i rrugëve lokale "Ushtari i lirisë"në Vërshec

Po ashtu kamë përgaditë kërkesën për alokimin e mjeteve nga THV (21) për gjashtëmbëdhjet projekte të investimeve kapitale.

- **Spektori i parandalimit të zjarrit**

Lënda: Raport gjashtëmujor i punës për periudhën Janar-Qershor 2025

Edhe këtë vit , periudha gjashtëmujore ka kaluar në kryerjen e punëve të lemisë së parandalimit të zjarrit, të kryerjes të inspektimeve të rregullta, të inspektimeve kontrolluese, si dhe inspektimeve të jashtëzakonshme me MPB-Agjencionin e Menagjimit të Emergjencave të disa objekteve me frekvenca të madhe të njerëzve si qendrave

tregtare,objekteve hoteliere e tj. Poashtu gjatë kësaj periudhe kemi dalë në vendin e ngjarjes me rastin e zjarreve, si dhe punë tjera të mbrojtjes nga zjarri.

23

Kontakti me njerëz,puna në teren, me udhëheqës të ndërmarrjeve apo kompanive të ndryshme, përveq rolit inspektues e ka edhe rolin këshillues dhe edukativ, në shërbim të parandalimit të zjarrit, shpëtimit të pasurisë dhe jetës së njerëzve.

Sa i përket zjarreve dhe daljeve në vendin e ngjarjes,duhet potencuar se në kuadër të senzibilizimit të qytetarëve për masat parandaluese nga zjarri, do të bëjmë shpërndarjen e një Apeli nëpër të gjitha fshatrat e komunës si dhe të ndërmarrjeve të ndryshme që të marrin masat parandaluese nga zjarri në sezonin e verës,duke i përdorur edhe mediat si mjet i rëndësishëm në senzibilizimin dhe parandalimin e zjarrit.Një vend të rëndësishëm zen edhe sezoni i korrije shirjes me kontrollimin e autokombajnave mbi gjendjen e tyre teknike,dhe posedimin e pajisjeve zjarrefikese.

Më poshtë do të evidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Qershor 2025 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1.Inspektime të rregullta.....	24
2.Në sektorin Publik.....	2
3.Në sektorin privat.....	22
4.Inspektime kontrolluese.....	11
5.Masa të shqiptuara.....	94
6.Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....	8
7.Vërtetime.....	4
8.Raport mbi dëmet e shkaktuara nga erërat në disa fshatra.....	1
9.Raporte.dhe shkresa tjera.....	6

Sektori i njësisë së zjarrëfikësave

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera, për periudhën kohore Janar - Qershor 2025 - Komuna e Suharekë

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera Janar-Dhjetor 2025													
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	22	16	4	0	1	0	1	0	4	4	0	0	0
Shkurt	16	11	0	3	2	0	0	0	3	3	0	1	1
Mars	29	24	0	4	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Prill	25	11	5	7	2	0	0	0	2	2	0	0	0
Maj	23	14	2	3	3	0	0	0	4	4	0	3	3
Qershor	19	16	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Gusht	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtator	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tetor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejtë	134	92	11	20	8	0	2	0	13	13	0	4	4

DREJTORIA PËR EKONOMI BUXHET DHE FINANCA

- Janë faturuar **3227** biznese me vlerë prej: **645,275.25 €**.
- Gjithashtu janë faturuar **140** shfrytëzues të pronës komunale në vlerë prej: **178,371.80 €**.
- Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar **183** kërkesa dhe vendime për zbritje të Taksës në Aktivitet ku vlera e stornuar është: **69,436.49 €**.
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet deri më 24.06.2025 janë: **90,797.55 €** ndërsa të hyrat nga Renta dhe Qeraja janë: **77,282.11 €**.
- Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **8,446** fletëpagesa për regjistrim të automjeteve, prej të cilave **192** fletëpagesa janë të liruara ndërsa vlera totale e pagesave është: **87,352.00 €**.
- Janë lëshuar **205** vërtetime dhe **14** çertifikata të ndryshme nga zyrtarët për shërbime të qytetarëve.
- Ne Qendrën e regjistrimit të biznesit deri me datë 24.06.2025 janë regjistruar **138** biznese, prej të cilave **48** janë Biznese Individuale, **89** janë SH.P.K. dhe **1** është Shoqëri Aksionare.
- Në këtë periudhë janë shuar **17** biznese.

Zyra për Regjistrimin e Pasurisë:

- Totali i regjistrimit të pasurive kapitale deri me datë 24.06.2025 është **349,269,929.07 €**, ndërsa i pasurive jo kapitale (vlera nën 1,000.00 €) është **3,024,742.10 €**.

Zyra e Thesarit:

- Nga fillimi i vitit deri më 24.06.2025 janë Çertifikuar dhe Aprovuar **2156** lëndë dhe **2,754,719.65€**²⁵ pagesa nga të gjitha programet e Komunës së Suharekës.
- Të gjitha këto pagesa, pas Çertifikimit dhe Aprovimit janë sistemuar në **33** regjistrator dhe janë arkivuar në Arkivin Financiar të KK në Suharekë.

Sektori i Tatimit në Pronë:

- Janë faturuar dhe dërguar te tatimpaguesit **13,493** fatura me vlerë mbi **1€**. Shuma totale e faturave për objekte dhe parcela është: **1,545,053.42 €**.
- Të hyrat nga Tatimi në Pronë (objekte dhe parcela) deri me 24.06.2025 janë: **446,059.29 €**.
- Sipas kërkesës së Ministrisë është duke u bërë rianketimi dhe vendosja e pikave të sakta të lokacionit për **2404** objekte të cilat kanë mbetur pa zonë të vlersimit.
- Gjithashtu janë lëshuar edhe **212** çertifikata për QPS.
- Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar **235** ankesa dhe kërkesa të tatimpaguesve.
- Janë regjistruar **43** objekte të reja, **50** modifikime dhe **90** objekte janë paisur me fotografi.

Të hyrat vetanake të realizuara deri me datë: 24.06.2025

- Të hyrat nga Tatimi në Pronë:-----**446,059.29 €**
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet:-----**90,797.55 €**
- Të hyrat nga Renta dhe Qeraja:-----**77,282.11 €**
- Të hyrat nga taksa e regjistrimit të automjeteve:-----**87,352.00 €**

Emërtimi i Të Hyrave	Buxheti i Alokuar	%	Buxheti i Shpenzuar	%	%
1	2	3	4	5	6=(4:2)
Paga & Shtesa:	6,074,290.10 €	35.78%	5,069,994.68 €	57.83%	83.46%
Mallra & Shërbime:	3,316,288.98 €	19.53%	1,516,456.54 €	17.29%	45.72%
Shpenzime Komunale:	431,600.00 €	2.54%	185,649.32 €	2.12%	43.01%
Subvencione & Transfere:	1,061,528.16 €	6.25%	433,680.39 €	4.94%	40.87%
Investime Kapitale:	6,094,639.94 €	35.90%	1,564,444.47 €	17.83%	25.65%
Totali:	16,978,347.18 €	100%	8,770,225.40 €	100%	51.66%
Raporti i shpenzimeve të buxhetit Komunal Janar – 24 Qershor 2025					

Gjatë periudhës së gjashtë-mujorit të parë të vitit 2025, sektori i aktiviteteve kulturore ka realizuar një sërë aktiviteteve të rëndësishme në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe individë të angazhuar. Aktivitetet janë organizuar me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të vlerave kulturore, si dhe për shënimin e datave të rëndësishme shtetërore.

Ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë në Komunën e Suharekës gjatë periudhës Janar – Qershor 2025.

Në këtë periudhë, sektori i aktiviteteve kulturore ka demonstruar një angazhim të madh për realizimin e aktiviteteve të cilat kanë kontribuar në promovimin e vlerave kulturore, ruajtjen e traditave dhe përfshirjen e komunitetit në aktivitete të ndryshme. Puna e këshillave organizative dhe angazhimi vullnetar i individëve ka qenë kyç për suksesin e këtyre aktiviteteve.

Drejtoria do të vazhdojë me angazhimin e saj për të organizuar aktivitete të tjera që pasurojnë jetën kulturore dhe rinore në komunitet.



Hapja e ekspozitës mbarë kombëtare e kuruar nga Ornela Bajraktari



Ora letrare poetike e Pavarësisë



Koncert muzikor nga GAM Theranda me këngë qytetare.



Një nga aktivitetet më të rëndësishme të këtij periudhe ka qenë realizimi i **Koncertit të Pavarësisë**, i organizuar nga **Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Shota"**. Ky koncert u realizua nën patronatin e **Kryetarit të Komunës, z. Bali Muharremaj**, dhe shënoi një moment të veçantë për bashkëngjitjen e komunitetit dhe nderimin e ngjarjeve historike të vendit. Aktiviteti ofroi një program të pasur me këngë dhe valle tradicionale, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e datës së shpalljes së Pavarësisë dhe duke kontribuar në ruajtjen e traditave kulturore.





- Në kuadër të aktiviteteve kulturore ndërkombëtare, me ftesën e Këshillit Organizativ nga Bashkia e Lezhës, Drejtoria e Kulturës ka pasur nderin të marr pjesë në manifestimin e kremtimit të Kuvendit të Lezhës. Ky manifestim ka shënuar një ngjarje të rëndësishme historike dhe kulturore, duke rikujtuar rëndësinë e këtij Kuvendi për historinë shqiptare.

Në këtë ngjarje, u mbajt një punëtori arti, ku artistë nga trevat shqiptare kontribuan për realizimin e një pikturë të veçantë kushtuar Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ky aktivitet kishte për qëllim mbështetje për Muzeun e Arteve, duke pasuruar koleksionin me një vepër artistike që nderon trashëgiminë tonë historike dhe kulturore. Kjo punëtori krijoi mundësi për bashkëpunim dhe shkëmbim artistik ndërmjet artistëve shqiptarë, duke theksuar rëndësinë e kujdesit për trashëgiminë kulturore.



Në muajin mars, janë zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme kulturore, ndër to vlen të theksohet Ekspozita e Artit me Gratë Krijuese, e cila u hap në Galerinë e Shtëpisë së Kulturës "Ukë Bytyçi" më 8 Mars, Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Ekspozita ishte e titulluar "Bota ime" dhe u kuruar nga Znj. Donjeta Krasniqi Kabashi. Ky aktivitet ishte një homazh për kontributin e jashtëzakonshëm të grave krijuese në fushën e artit dhe u bë një mundësi për t'u njohur më nga afër me veprat e artit që pasqyrojnë perspektivën dhe përvojat e grave në shoqëri. Aktiviteti u shoqërua me një numër të madh vizitorësh dhe pati një impakt të rëndësishëm në promovimin e artit dhe kulturës.





Ditës Ndërkombëtare të Matematikës

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Matematikës, u organizua një ekspozitë interesante nga shkollat fillore, e titulluar "Arti dhe Matematika". Ky aktivitet kishte për qëllim lidhjen e dy disiplina të rëndësishme, duke nxitur kreativitetin dhe mendimin logjik tek fëmijët. Në këtë ekspozitë, nxënësit e shkollave fillore paraqitën projekte dhe punime që pasqyronin se si matematika mund të përdoret në krijimin e artit dhe si arti mund të ilustrojë konceptet matematikore. Ky aktivitet u ndoq me interes të madh nga fëmijët dhe mësuesit, duke krijuar mundësi për të nxitur ndërveprimin e disiplina të ndryshme dhe për të promovuar vlera të tilla si bashkëpunimi dhe inovacioni.



Koncert i pinaos duo me pianistët Ledian Shala dhe Agron Shujaku



Nga data 7 deri më 16 mars, u realizua punitoria inovative dhe artistike e titulluar "Inspirim nga Bleta", e cila u realizua në bashkëpunim me Artaction Group, profesorët nga Universiteti Adelphi, New York, SHBA dhe Universiteti Shtetëror i Pensilvanisë, SHBA. Ky aktivitet u mbajt në Shtëpinë e Fellbahut, dhe morën pjesë rreth 50 të rinj nga grupet e artit, robotikës, baletit dhe klasa e gjuhës angleze. Punitorja ofroi mundësi për të rinjtë të zhvillojnë aftësi krijuese dhe inovative, duke u frymëzuar nga koncepti i bletëve dhe natyrës. Pas përfundimit të punëtorisë, u hap ekspozita me krijimet artistike dhe inovative të pjesëmarrësve, e cila tërhoqi vëmendje të madhe dhe shprehu potencialin e të rinjve për t'u angazhuar në fusha të ndryshme të artit dhe shkencës.



Më 26 mars, u organizua Akademi Përkujtimore në kujtim dhe nderim të viktimave civile nga Komuna e Suharekës, të cilët humbën jetën gjatë luftës. Ky aktivitet shërbeu si një homazh për ata që dhanë jetën dhe për ata që ende mungojnë. Gjatë ceremoni, të pranishmit i përshëndetën Kryetari i Komunës, Z. Bali Muharremaj, dhe Andin Hoti, Kryetar i Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit. Ata theksuan rëndësinë e kujtesës dhe respektit për viktimat e pafajshme të luftës, duke kërkuar gjithashtu më shumë përpjekje për të zbuluar të vërtetën dhe për të siguruar drejtësi. Aktiviteti u shoqërua me një program artistik, në të cilin u angazhua grupi GAM Theranda, i cili kontribuoi me performanca që përçuan mesazhe të fuqishme për paqe dhe kujtim.



Më 26 mars, u mbajt promovimi i librit "*Masakra serbe në Komunën e Suharekës 1998- 1999*", me autorë Milazim Elshani dhe Rahman Rexhaj. Ky libër trajton ngjarjet tragjike të masakrave që ndodhën gjatë periudhës së luftës në Komunën e Suharekës dhe kontribuon në dokumentimin e asaj periudhe të errët të historisë.



Në Shtëpinë e Kulturës "Ukë Bytyçi" janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme nga shkollat dhe qerdhet e fëmijëve, të cilat kishin për qëllim promovimin e aktiviteteve edukative dhe kreative për fëmijët. Këto aktivitete përfshinin programe shkollore dhe paraqitje filmash vizatimorë me karakter edukativ, që synonin t'u ofronin fëmijëve mundësi për të mësuar dhe argëtuar në një ambient të sigurt dhe stimulues. Aktivitetet u ndoqën me entuziazëm të madh nga fëmijët dhe prindërit, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive sociale dhe intelektuale të të rinjve, si dhe në forcimin e lidhjeve ndërmjet shkollave, qerdheve dhe institucioneve kulturore.

Gjatë këtij tremujori, nxënësit e Shkollës Fillore "17 Shkurti" nga Shiroka patën një vizitë të këndshme në Shtëpinë e Kulturës "Ukë Bytyçi", aktivitet i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë. Gjatë vizitës, nxënësit u njohën me aktivitetet kulturore që ofron ky institucion dhe rëndësinë e tij në promovimin e kulturës në komunitet. Pas vizitës, ata patën mundësinë të shfaqen një film edukativ, duke përjetuar një eksperiencë argëtuese dhe frymëzuese.



Me 6 Mars, Shoqata e Personave të Verbër në Suharekë organizoi një takim për të festuar Ditën e Mësuesit dhe Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me mbështetje nga Komuna e Suharekës. Në këtë event mori pjesë Zonja Mihrije Berisha Suka, Nënkyetare e Komunës dhe Albulena Kokollari Drejtore e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgates, të cilat theksuan rëndësinë e ngjarjes dhe premtoi vazhdimin e mbështetjes për gratë dhe vajzat e komunitetit.



Kopshti i Fëmijëve "Ora" organizoi një aktivitet të veçantë për nder të 7-8 Marsit, i cili simbolizon festën e rëndësishme për gratë dhe nënat. Në këtë event, u zhvillua gara e dashurisë, ku fëmijët garuan bashkë me nënat e tyre, duke sjellë shumë buzëqeshje dhe emocione të veçanta në mesin e pjesëmarrësve. Ky aktivitet u përshëndet dhe u koordinua në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës.



Aktiviteti për Ditën Botërore të Teatrit

Në kuadër të Ditës Botërore të Teatrit, Drejtorja e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës, në bashkëpunim me Shkollën “Shkëndija”, organizoi një aktivitet të veçantë për nxënësit e kësaj shkolle. Ky aktivitet u mundësoi nxënësve të shprehnin talentin dhe pasionin e tyre për artin e teatrit në Shtëpinë e Kulturës “Ukë Bytyçi”.



Vënia e Gurthemelit të Kullës së Dëshmorëve në Doberdelan

Në kuadër të projekteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe forcimin e identitetit kombëtar, u vu gurthemeli i ndërtimit të Kullës së Dëshmorëve në Doberdelan, një investim i rëndësishëm i Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë - Komuna Suharekë. Ky projekt simbolizon nderimin dhe kujtimin për heroizmin e dëshmorëve dhe do të shërbejë si një pikë referimi për brezat e ardhshëm.



Në përvjetorin e rënies së Dëshmorit të Kombit, Ushtar Kavaja, nderojmë kujtimin dhe sakrificën e tij për atdhenë.



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë, "Kopshti I Fëmijëve "ORA" patën mundësinë të vizitonin Bibliotekën e Qytetit!

Bashkëbisedimit me gazetaren znj. Jeta Xharra Angazhimi i saj i palodhur dhe kontributi i saj për përmirësimin e shoqërisë sonë janë të jashtëzakonshme.



Me datë 02 Maj, u themelua Shoqata e Bjeshkatarisë dhe Alpinizmit “Maja e Bajrakut”! E iniciuar nga një grup entuziastësh që kanë ngjitur majat më të larta të trevave shqiptare, kjo shoqatë do të promovojë ecjen, alpinizmin dhe aktivitetet në natyrë.



Vizitë në Shoqatën e të Shurdhërve në Suharekë

Gjatë këtij takimi u diskutua për kërkesat, nevojat dhe sfidat me të cilat përballet shoqata, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit me Drejtorinë dhe Komunën e Suharekës



Vizitë në shoqatën Sytë kërkojnë dritë - SKD dhe të diskutojmë për gjendjen e kulturës në komunën tonë, nevojat, sfidat dhe prioritetet tona në këtë fushë.



Vizitë në organizatën Handikos dhe të takohem me stafin e tyre të jashtëzakonshëm.

Një ekip i palodhur, plot motivim dhe përkushtim ndaj punës humanitare që bëjnë çdo ditë. Ishte frymëzuese të shihje se si me zemër të madhe dhe profesionalizëm mbështesin ata që kanë më së shumti nevojë.



Shfaqjen teatro-muzikore “Jetë apo Vdekje”, të përgatitur nga Qendra për Mendim Kreativ “Shtëpia e Fellbahut” në Suharekë, në bashkëpunim me nxënësit e Gjimnazit “Jeta e Re”.

Shfaqja u mbajt në Shtëpinë e Kulturës “Ukë Bytyqi” dhe solli mesazhe të fuqishme edukative për gjeneratat e reja.



Përurohet Shtëpia e Kulturës “Afërdita” në Mushtisht

Më 21 maj 2025, në Mushtisht u përuhua Shtëpia e re e Kulturës “Afërdita” – një projekt i rëndësishëm i realizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Mërgatë.

Ky investim i ri kulturor nuk është vetëm një hap drejt përmirësimit të infrastrukturës kulturore, por edhe një angazhim konkret për krijimin e hapësirave të dinjitetshme për artistët, të rinjtë dhe të gjithë qytetarët.




Takim me gratë e Komunës së Suharekës dhe përfaqësues të OJQ-ve

Është mbajtur sot një takim me organizatave joqeveritare, në kuadër të diskutimeve për hartimin e Kornizës Afatmesme të Buxhetit për periudhën 2026-2028.



Ekspozita përkujtimore “Në hapat e tyre të lirisë” është një thirrje e heshtur që flet më shumë se çdo fjalë. Ajo na kujton se liria jonë nuk erdhi lehtë. Se ajo u pagua me jetën e më të pafajshmëve, fëmijëve që s’arritën të rriten, që s’arritën të ëndërrojnë, e që u bënë simbol i dhembjes dhe i qëndresës sonë kolektive.



Aktivitetet përkujtimore dhe festive me rastin e 13 Qershorit – Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Komunës së Suharekës.



Një pjesë e xhirimeve të serialit Toka po zhvillohet në mullirin tradicional të Adem Bytyqit në fshatin Breshanc një vend me vlera të veçanta historike dhe kulturore.


Përmes këtij projekti artistik, promovohet trashëgimia kulturore të vendit tonë.



Sektori I Rinisë

Bashkë me zyrtaren e Rinisë, morëm pjesë në takimin për diskutimin rreth ndryshimit të rregullores për rininë, si pjesë e serisë së workshop-eve të organizuara nga @OSCEKosovo.

Ky takim ishte një mundësi e shkëlqyer për të diskutuar mbi mënyrat se si mund të zbatohet dhe përmirësohet kuadrin ligjor për rininë në nivel lokal.



Për nder të ditës së Tokës është ndërmarr aksione vetëdijësuese dhe angazhim qytetar, po kontribuojmë për një të ardhme më të gjelbër.



Trajnimi “Soft skills for future LEADERS” nga Znj. Shenaj Shala u mirëprit me shumë entuziazëm në kuadër të programit SHeroic Academy, The-Art për edukimin dhe fuqizimin e vajzave dhe grave.



Ecja në Natyrë – “Drejt Malit”

Ky aktivitet kishte për synim promovimin e aktivitetit fizik në natyrë, edukimin mjedisor dhe zhvillimin social të nxënësve, në një atmosferë motivuese dhe gjithëpërfshirëse.



Shoqata “Autizmi” Suharekë u mbush me ngjyra, buzëqeshje dhe dashuri! Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, u organizua një aktivitet i veçantë për të festuar së bashku me fëmijët e mrekullueshëm dhe familjet e tyre.



Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në HANDIKOS

Sot isha shumë e lumtur që isha pjesë e këtij aktiviteti të jashtëzakonshëm dhe shumë emocionues të organizuar në HANDIKOS me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.



BLIOTEKA “HAJDIN BERISHA”- SUHAREKË

I. RAPORTI STATISTIKOR

II.

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, Biblioteka “Hajdin Berisha” ka realizuar me sukses misionin e saj në ofrimin e shërbimeve për lexuesit dhe komunitetin në përgjithësi.

Të dhënat statistikore për këtë periudhë janë si më poshtë:

- Numri i përgjithshëm i lexuesve të regjistruar: 864
- Numri i përgjithshëm i librave të lexuar: 3247
-

Sektori i Fëmijëve:

- Lexues të regjistruar: 631
- Ndërrime të librave: 2537

Sektori i të Rriturve:

- Lexues të regjistruar: 233
- Ndërrime të librave: 710

Salla e Leximit:

- Përdorues të sallës së leximit: 1779

Libra të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës: 101

II. AKTIVITETET KULTURORE DHE EDUKATIVE

Gjatë këtij gjashtëmujori, Biblioteka ka organizuar një sërë aktivitete që kanë pasuruar jetën kulturore dhe kanë rritur ndërveprimin me lexuesit:

- 24 Mars – Vizita e nxënësve të shkollës “7 Marsi” me rastin e Ditës Botërore të Gjuhës Amtare;
- 17 Shkurti – Vizita e organizuar në bibliotekë nga shkolla fillore e fshatit Shirokë.
- 2 Prill – Dita Botërore e Librit për Fëmijë, me pjesëmarrjen e nxënësve të:
 - Shkollës “Lidhja e Prizrenit” – Budakovë
 - Shkollës “7 Marsi” – Suharekë
 - Kopshtit “Ora” – Suharekë
 (Fëmijëve iu lexua një përrallë nga shkrimtari **Fadil Bytyqi**)
- 23 Prill – Dita Botërore e Librit, shënuar me aktivitete letrare dhe prezencë të lexuesve të rinj;
- Promovimi i librit “Sythat e dritëhijeve të jetës” nga autorët Sedat Gashi dhe Miranda Fondaj;
- Promovimi i librit “Shpirti më tha” nga autorja e re **Laureta B. Reshani**;
- Vizita e shkrimtarit Hamit Gurguri në Bibliotekën “Hajdin Berisha”;
- Promovimi i librit “Xhemajl Ramaj- Uragan i Lirisë”- Fikret Ramaj;
- Pjesëmarrja e stafit në konkursin e poezisë “Ragip Sylaj”;

III. RAPORTI I PËRPUNIMIT TË LIBRAVE DHE I SHËRBIMEVE

Biblioteka ka zhvilluar dhe zbatuar praktika të mirëfillta profesionale në fushën e përpunimit të librit dhe ofrimit të shërbimeve bibliotekare:

- Hartimi i thirrjes për interesuarit për krijimin e dy klubeve të leximit;
- Hartimi i **planeve zhvillimore dhe vjetore**, si dhe raportimi mbi rezultatet;
- **Menaxhimi financiar dhe administrimi i mjeteve materiale** të siguruara nga participimi;

- **Përpunimi i librave të dhuruar**, përfshirë:
 - Caktimin e signaturave sipas **sistemit KUD**
 - Regjistrimin në **libër inventari**
- **Shërbimet për lexuesit:**
 - Ndërrimi i librave dhe **konsultimi**;
 - Ofrimi i **informacionit dhe orientimit**;
 - **Mbikëqyrja e aktivitetit** brenda ambienteve të bibliotekës.
- Kujdes i veçantë ndaj **librave të humbur** dhe zëvendësimi i tyre;
- Hartimi i **listës për blerje të librave** dhe adresimi në MKRS.

Suharekë, më 24 qershor 2025

Biblioteka “Hajdin Berisha”

Biblioteka “Hajdin Berisha”




Në kuadër të shënimit të javës së Bibliotekës u bë promovimi i librit “Sythet e dritëhijeve të jetës” me Bashkëautor Sedat Gashi dhe Miranda Fondaj.



Promovimin e librit të ri të autores Laureta Reshani. Një ditë e veçantë kushtuar fjalës së shkruar dhe krijimtarisë së saj të veçantë.



Në Studenqan u promovua Libri I autorit Mehdi Përzhaku “Studenqani nëpër sfida të historisë”



23 Prilli është dita botërore e librit dhe e të drejtës së autorit dhe me këtë rast u shënua kjo ditë me pjesëmarrjen e institucioneve parashkollë dhe shkollave të mesme nga komuna e jonë. Ky aktivitet u realizua në Bibliotekën Komunale “Hajdin Berisha”



Promovimi i librit "XHEMAJL RAMAJ – URAGAN I LIRISË" nga autori Fikret Ramaj u mbajt në Bibliotekën "Hajdin Berisha", në nderim të dëshmorit Xhemajl Ramaj nga Reqani i Suharekës.



Në Shtëpinë e Kulturës Ukë Bytyçi u bë promovimi i librit "Maçiteva ndërmjet legjendës dhe realitetit". Autor i librit është Prof. Avdyll Hajredini



• AKTIVITETE NË SEKTORIN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Në sektorin e trashëgimisë kulturore, janë zhvilluar aktivitetet rutinore në Muzeun e Qytetit, ku janë organizuar vizita nga qytetarët dhe nxënësit e shkollave. Këto vizita kanë pasur për qëllim të thellojnë njohuritë dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore për komunitetin.

Përveç vizitave në muze, janë organizuar vizita në teren për të monitoruar gjendjen e aseteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Këto vizita kanë kontribuar në ruajtjen dhe vlerësimin

e këtyre pasurive kulturore, duke siguruar që asetet të mbrohen dhe ruajnë për brezat e ardhshëm. Ky angazhim është pjesë e përpjekjeve tona për të forcuar ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në komunën tonë.

Vizita e Arkeologes Franceze Alison Raifin Soles dhe Historianit John Howell në Muzeun e Suharekës

Muzeun e Suharekës e vizituan arkeologja franceze Alison Raifin Soles dhe historiani anglez John Howell, së bashku me arkeologun Prof. Dr. Sedat Baraliu. Gjatë vizitës, ne i njoftuam mysafirët për artefaktet e shumta që janë ekspozuar në muze, duke përfshirë pasuritë kulturore dhe historike, si dhe pjesën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe dëshmorët tanë.

Profesoresha Alison Raifin Soles, një njohëse e shkëlqyer e historisë dhe arkeologjisë, shprehu interes të madh për trashëgiminë kulturore të rajonit dhe njoftoi se po planifikon të vijë në të ardhmen me një projekt hulumtimi, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Komunën tonë. Një nga mundësitë e planifikuara është hulumtimi i Tumës së Gjinocit, për të cilën koha do të tregojë se si do të zhvillohen këto punë.

Ky takim është një mundësi e shkëlqyer për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arkeologjisë dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Suharekës dhe Kosovës.



Vizita e Nxënësve nga SHFMU "Shkëndija" në Muzeun e Suharekës

Nxënësit e klasave IV1 dhe IV2 të SHFMU "Shkëndija" të Suharekës, së bashku me mësuesit e tyre Vjollca Berisha dhe Hysni Kadriaj, vizituan Muzeun e Suharekës. Kjo ishte vizita e parë për këtë grupmoshë, dhe ishte një kënaqësi të shihnim interesin dhe kuriozitetin e tyre për të mësuar më shumë rreth kaluara jonë arkeologjike, historike dhe kulturore.



Aktivitetet për Nder të 7 Shkurtit - Dita e Pavarësisë së Kosovës

Në kuadër të aktiviteteve dhe njësive mësimore për nder të 7 Shkurtit 2008, ditës së Pavarësisë së Kosovës, sot fëmijët e klasëve të para të SHFMU "7 MARSII" në Suharekë realizuan një aktivitet të veçantë. Ky aktivitet ishte një mundësi për t'i njohur ata me rëndësinë e kësaj date historike, e cila simbolizon arritjen e Pavarësisë së Kosovës dhe sakrificat e popullit për liri.



Vizita e Nxënësve të SHFMU "Dituria" për Nder të 17 Shkurtit - Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Në kuadër të vizitave për nder të 17 shkurtit 2008, Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, sot nxënësit e klasës VI të SHFMU "Dituria" nga Samadrexha, së bashku me mësuesin e Gjuhës Shqipe Muharrem Kotorri, vizituan Muzeun e Qytetit. Kjo vizitë ishte një mundësi e shkëlqyer për nxënësit që të mësojnë dhe të njohin më mirë historinë e Kosovës dhe rëndësinë e Ditës së Pavarësisë.



Vizita e Parashkollorëve të Sh.F.M.U. "Ramë Bllaca" në Muzeun e Suharekës për Nder të 17 Shkurtit - Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Për nder të 17 shkurtit 2008, datës së shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Muzeu i Qytetit po vizitohet nga nxënës të shkollave për të nderuar dhe respektuar këtë ditë të shënuar të shtetit tonë. Sot, Muzeun e Suharekës e vizituan parashkollorët e Sh.F.M.U. "Ramë Bllaca" nga Bllaca, si pjesë e aktiviteteve edukative që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin tek brezat e rinj për rëndësinë e kësaj dite historike.



Aktiviteti për Nder të 17 Shkurtit - Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës nga Grupi i Parashkollorëve të "Perspektiva" - Prizren

Sot, në orët e mërkurës, grupi i dytë i fëmijëve parashkollor nga institucioni "Perspektiva" - Prizren, vazhduan aktivitetin dhe programin e tyre me rastin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Fëmijët ishin veshur me veshje që përfaqësonin flamurin e Republikës së Kosovës, duke shprehur krenarinë e tyre për këtë ditë të shënuar.

Programi ishte i larmishëm dhe përgatitur enkas për të nderuar luftarët e lirisë, dëshmorët, si dhe Komandantin legjendar Adem Jashari, dhe të gjithë heronjtë që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Pikat e programit përfshinin këngë dhe poezi, duke rritur ndërgjegjësimin tek fëmijët për vlerat e lirisë dhe rëndësinë e sakrificave të bëra për këtë liri.



Aktivitetet për Nder të 17 Shkurtit - Dita e Pavarësisë së Kosovës nga Fëmijët Parashkollor të Qerdhës "Perspektiva" - Prizren

Për nder të përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008, sot fëmijët parashkollor të Qerdhës "Perspektiva" - Prizren, vizituan Muzeun e Qytetit Suharekë për të realizuar një varg aktiviteteve kulturore dhe muzikore.

Për t'i përshëndetur mysafirët nga Prizreni, e pranishme ishte edhe Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, znj. Albulena Kokollari, e cila falënderoi organizatorët dhe kontribuoi me prezencën e saj, duke vlerësuar angazhimin dhe impenjimin e tyre.



Për nder të Ditës së librit, disa shkolla vizituan edhe Muzeun e Qytetit. Në

mesin e tyre ishte edhe SHFMU "Kongresi I Manastirit", - Studençan.

Gjatë ditës nxënësit e kësaj shkolla me disa paralele të dy cikleve dhe nën kujdesin e arsimtarëve të tyre i bënë vizit Muzeut.



SHFMU “Naum Veqilharxhi” – Mohlan

Vizitë nga nxënësit e klasave VIII¹ dhe VIII², së bashku me drejtoreshën Liridona Kabashi, arsimtarin e lëndës Edukatë Qytetare, Fehmi Sopa, dhe kujdestarët e klasave, Ali Kabashaj dhe Shyhrete Tahiri.



Mulliri i Haki Bytyqit – Breshancë

Në kuadër të emisionit të RTK-së “Mirëmëngjesi Kosovë”, sot, bashkë me gazetaren Teuta Mujaj, realizuam një dokumentar me temën: “Mulliri i ujit – roli, historiku dhe rëndësia që ka pasur në shoqërinë tone.



SHFMU " DËSHMORËT E KOMBIT", - Vraniq.

Nxënësit e klasës III¹ , së bashku me mësuesen e tyre Dafina Muqa në kuadër të planprogramit mësimor nga Gjuha shqipe , vizituan Muzeun e Qytetit.

Vizitat e tilla nga femijet e të gjitha moshave për tu njohur me të kaluaren tonë të lashtë materiale dhe historike janë dëshmi e interesimit në rritje të nxënësve të shkollave tona.



Për të biseduar lidhur me projekte qe parashihet të realizohen në Muzeun e Suharekës, por dhe aktivite hulumtuese në teren si në Kalanë e Kastercit dhe Lokalitetin e Hisarit të cilat veq kanë filluar, kishim mysafir Arkeologun prof. Dr. Shafi Gashin.



• AKTIVITETE SPORTIVE NË PALESTRËN E SPORTIT "13 QERSHORI"

Në palestrën e sportit "13 Qershori" janë zhvilluar aktivitete të rregullta sipas orarit, përfshirë trajnime të shkollave sportive dhe klubeve të ndryshme. Po ashtu, janë realizuar garat e rregullta sportive sipas ligave në sportet e ndryshme, si basketboll, volejboll, shigjetari, si dhe garat e sportit shkollor, përfshirë volejbollin në nivel rajonal dhe lokal.

Garën e Superligës së Futbollit e zhvilluan të dy klubet tona, të cilat garojnë në kuadër të Superligës, si dhe sipas orarit në stadiumin e qytetit dhe si mysafirë. Këto gara shërbyen si mundësi për zhvillimin dhe avancimin e sportistëve dhe ekipet përkatëse.

Gjithashtu, u zhvilluan garat komunale në volejboll, ku morën pjesë ekipe nga shkollat e komunës tonë. Vlen të theksohet disiplinimi dhe përgatitja e shkëlqyer sportive e ekipeve, që tregojnë nivel të lartë angazhimi dhe përkushtimi në sport. Ky aktivitet ka kontribuar në promovimin e sporteve dhe ka forcuar lidhjet mes shkollave dhe klubeve lokale.





Garat Rajonale të Volejbollit me Prizrenin

Pas garave komunale, sot u mbajtën garat rajonale të volejbollit me Prizrenin, ku shkollat nga komuna jonë arritën suksese të shquara në tri kategori. Ekipet e përfaqësuan me nder komunën tonë dhe regjionin e Prizrenit, duke siguruar mundësinë për të përfaqësuar këtë regjion në garat republikane.

Përgëzime për të gjithë mësime dhe Sportin Shkollor - Suharekë, të cilët kontribuan në mbarëvajtjen dhe organizimin e garave. Ky sukses është rezultat i përkushtimit dhe angazhimit të vazhdueshëm të shkollave dhe ekipeve, dhe është një hap i rëndësishëm drejt promovimit të sportit dhe zhvillimit të talenteve rinore në nivel rajonal dhe kombëtar.





Gara “Kupa e Pavarësisë 2025” në Suharekë

Suhareka pati nderin të mirëpriste garën "Kupa e Pavarësisë 2025", e organizuar nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës, e cila u zhvillua në Shkollën Profesionale "Avdyll Rama" në Shirokë. Ky eveniment ka përfaqësuar një mundësi të shkëlqyer për promovimin e shigjetarisë dhe zhvillimin e këtij sporti në nivel kombëtar.

Gara solli konkurrencë të fortë dhe ishte një platformë për sportistët e shigjetarisë për të treguar aftësitë dhe talentin e tyre. Ky aktivitet ka pasur një rëndësi të veçantë për komunitetin sportiv të Suharekës dhe ka kontribuar në rritjen e angazhimit të rinisë në aktivitete sportive, duke u bërë një ngjarje e rëndësishme për kalendarin e aktiviteteve sportive të vitit 2025.





Shoqata e Autizmit në Suharekë dhe "Klubi Atletik Theranda 1992" organizoi Minimaratonën Humanitare "Te Vrapojmë së Bashku me Fëmijët 2025", për të rritur ndërgjegjësimin dhe mbështetje për fëmijët me autizëm.



Suksesi i klubeve të futbollit nga Komuna e jonë që bënë gara në Superligë KF. Ballkani dhe KF. Suhareka, u dëshmuar pran shumë shikuesve duke na bërë krenar të gjithëve. Ishte një lojë e veçantë sepse garuan 2 ekipe vendase.



Kurorzimi me fitore të KV Theranda në garat e volejbollit për vajza në duel me KV Prishtina është edhe një sukses i radhës për sportin e Komunës tonë.



Klubi i Volejbollit “Gjinoci” me fitorën e radhës arrinë të ruaj vazhdimin e garave në ligën e parë.



Me rastin e Ditës së Shkollës, në Shfmu "Shaban Mazreku" Sopijsë u përurua edhe fusha e re sportive, kjo tregon angazhimin tone për përmirësimin e infrastrukturës Sportive edhe nëpër fshatra.



Në Studençan u mbajt turneu i futbollit të vogël, Morën pjesë 56 ekipe, që luajtën futboll për të nderuar dëshmorët e Studençanit. Ky turne ka për qëllim të ruajë dhe nderojë kujtimin e atyre që dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë tonë.



Mbështetja për shkollat sportive nga DKRSM po e jep efektin pozitiv në edukimin e sportistëve të rinjë si për shembull ekipi i mrekullueshëm i klubit **Shkolla e Basketbollit "Therandabasket"** nga Komuna jonë është shpallur kampionë të grupmoshës U16!



Pas fitorës 2-3 ndaj Prishtinës, djemtë tanë U-21, KF Ballkani edhe zyrtarisht konfirmohen kampionë të Republikës.



Turneu tradicional Sadik Ramadanaj

Në fshatin Sopijë u organizua turneu tradicional përkujtimor kushtuar Sadik Ramadanaj, me mbi 100 ekipe pjesëmarrëse.



Datë 25.06.2025

Drejtore e Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Albulena'.

Albulena Kokollari



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



25.06.2025

Nr. Prot. _____

KODI I IDENTIFIKIMIT		KODI I IDENTIFIKIMIT	
TIP I DOKUMENTIT		TIP I DOKUMENTIT	
NUMRI I DOKUMENTIT		NUMRI I DOKUMENTIT	
DATA E DOKUMENTIT		DATA E DOKUMENTIT	
SIGNATURA		SIGNATURA	
01 052 36041		L	

Për:	Bali MUHARREMAJ - Kryetarin e Komunës-Suharekë
Nga:	Kimete Bajraktari – Drejtor për Administratë-Suharekë
Lënda:	Raport pune për Janar-Qershor 2025
Datë	25.06.2025



DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

1. HYRJE

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Administratës në periudhën e Janar- Qershor të vitit 2025. Raporti paraqet aktivitetet dhe punën e Drejtorisë, sipas fushës së përgjegjësi ligjore, të bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2025.

Drejtorja e Administratës, në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për:

Ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale. Bënë ofrimin e shërbimeve administrative, për qytetarët e Komunës së Suharekës, në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj.

Përgjegjësitë e administratës:

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale të Drejtorisë së Administratës përfshijnë:

